EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5692
E shtunë, 2 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Limaj: Kompleksi Memorial në Prekaz, prioritet i qeverisë

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISMAJL KURTESHI

FAQE 4-5

Taksa duhet të mbetet, qeveria duhet të bjerë

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka thënë se taksa ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës duhet të mbetet në fuqi, kurse qeveria duhet të bjerë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se qeveria duhet t'ua sqarojë ndërkombëtareve se taksa nuk është pengesë për vazhdimin e dialogut në mes të dy shteteve. Kurteshi e ka mohuar mundësinë që vendi të ketë një qeveri gjithëpërfshirëse. Sipas tij, e vetmja zgjidhje për vendin janë zgjedhjet e parakohshme

Pas tri jave grevë, të hënën nis procesi mësimor

Nxënësit dhe mësimdhënësit, pas një greve trejavëshe, do t'i kthehen procesit mësimor të hënën. Marrëveshja për ndërprerjen e grevës në arsim është arritur të premten në takimin e përbashkët të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryeministrit Ramush Haradinaj dhe kryetarit të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), Rrahman Jasharaj. Me këtë rast kreu i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, ka thënë se marrëveshja parasheh rritjen e pagave përafërsisht në nivelin që e kanë kërkuar mësimdhënësit, deri në 30 për qind

FAQE 3



Nga e hëna fillon procesi i organizimit të provimeve në UP

FAQE 7

AKTUALE

PSE PO SULMOHEN UNIVERSITETET PUBLIKE? F. 11

Prof. Asoc. Dr. Bajram KOSUMI

HAPET NJË PIKË E RE E QENDRËS SË MJEKËSISË URGJENTE NË PRISHTINË F. 7

KLINA BËHET ME BUST TË SKËNDERBEUT F. 10

EKONOMI

KDI-ja: VONESA TË MËDHA DHE PARREGULLSI PËR DHËNIEN E KONTRATËS PËR MIRËMBAJTJE TË RRUGËVE F.9

SOT MBAHET SEANCA PËR VOTIMIN E BUXHETIT F.9

KULTURË

KOORDINATORI HOTI NIS BASHKËPUNIMIN ME INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË F. 6

SPORT

SHALA: DO TA PREZANTOJMË DENJËSISHT HENDBOLLIN E KOSOVËS NË SPANJË F. 16

SALIHU: BESA RIKTHEHET NË SUPERLIGË F. 16

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Mogherini dhe Hahn thonë se dialogu duhet të vazhdojë

Ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, gjatë vizitës në Rumani, ka takuar shefen e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, dhe komisionarin e Zgjerimit të BE-së, Johannes Hahn, të cilët kanë thënë se dialogu Kosovë - Serbi patjetër duhet të vazhdojë dhe se do të bëjnë përpjekje për ta rifilluar këtë proces

Prishtinë, 1 shkurt - Në kuadër të vizitës në Rumani dhe pjesëmarrjes në takimin joformal të organizuar nga Rumania si kryesuese e Presidencës së radhës së Këshillit të BE-së, zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, në margjina të takimit joformal, ka takuar edhe homologun slloven, Miro Cerar, përfaqësuesen e lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini, dhe komisionarin e Zgjerimit të BE-së, Johannes Hahn.

Gjatë takimit me ministrin e Sllovenisë është biseduar për mbështetjen e Republikës së Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave, marrëdhëniet dypalëshe dhe mbështetjen e tyre në proceset e tjera integruese euroatlantike.

Ndërsa me Mogherinin dhe Hahnin, Pacolli ka folur për procesin e dialogut mbi normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Ai ka kërkuar që dialogu të vazhdojë pavarësisht prej masës së vendosur nga Qeveria e Kosovës.

Zyrtarët e BE-së kanë thënë se dialogu patjetër duhet të vazhdojë dhe se do të bëjnë përpjekje për ta rifilluar këtë proces.

Behgjet Pacolli është takuar edhe me ministrin e Jashtëm të Polonisë, Jacek Czaputowicz, ministrin e Jashtëm të Çekisë Tomas Petricek, dhe ministrin e Jashtëm të Sllovakisë, Miroslav Lajcak. Gjatë takimit me kryediplomatin polak, ministri i Jashtëm, Pacolli, është siguruar për përkrahjen e këtij shteti në të gjitha proceset integruese ndërkombëtare të vendit tonë si dhe liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Më pas është shfaqur interesim mbi mbarëvajtjen e procesit të dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, përderisa diplomati polak ka kërkuar rishqyrtimin e taksës së vendosur ndaj Serbisë.

Samiti Procesi i Berlinit, i cili sivjet do të mbahet në Poloni, ka qenë temë tjetër e diskutimit në mes dy bashkëbiseduesve, ku u theksua se Polonia mbetet e përkushtuar për procesin e zgjerimit edhe me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe do ta ndihmojë atë në përafrimin me BE-në.

Ministri Pacolli ka takuar edhe ministrin e Jashtëm të Çekisë, Tomas Petricek.

Në kuadër të këtij takimi dypalësh, ministri çek ka shprehur mbështetjen e Çekisë në të gjitha proceset e rëndësishme të integrimit ndërkombëtar të Kosovës.

Po në këtë takim është diskutuar edhe për thellimin e bashkëpunimit ekonomik, me theks të veçantë për krijimin e kushteve për investitorët çekë në Kosovë.

Gjithashtu, është bërë me dije se po punohet edhe për përcaktimin e një date për vizitën e ministrit Pacolli në Pragë, me qëllim të thellimit të bashkëpunimit në mes të dy vendeve.

Gjatë qëndrimit në Bukuresht ministri Pacolli është takuar edhe me ministrin e Jashtëm të Sllovakisë, Miroslav Lajçak.

Ministri Lajçak ka shprehur interesimin e shtetit sllovak për stabilitetin në Ballkan dhe mbështetjen e dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, ndërsa ka bërë me dije se së shpejti do ta vizitojë vendin tonë si kryesues i radhës i OSBE-së.

Sipas kryediplomatit Lajçak, Sllovakia nuk e kundërshton procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën, ndërkohë që është shprehur interesimi i këtij shteti për thellimin e bashkëpunimit dhe diskutimit të mundësive për hapjen e Zyrës Përfaqësuese të vendit tonë në Bratislavë.

Basha: Vendi në prag kolapsi

Tiranë, 1 shkurt - Partia Demokratike organizoi të premten një takim me të gjitha shoqatat e bizneseve dhe sipërmarrësit për prezantimin e shtyllave kryesore të programit ekonomik të saj. Në fjalën e tij, kreu i PD-së, Basha, theksoi se gjendja e ekonomisë, punësimit, sipërmarrjes dhe mirëqenies së shqiptarëve, pas gati gjashtë vjetësh të qeverisjes së Edi Ramës, është në prag kolapsi. "Shqiptarët kanë humbur shpresën, qindra mija kanë braktisur vendin, të tjerë po bëjnë përpjekje për ta braktisur. Rinia e papunë, e pashpresë, dijedashëse, por me sistem arsimor në rrënim, është në protestë dhe qindra mija të rinj shpresën e gjejnë vetëm në emigracion. Sipërmarrja e vogël, e mesme apo e madhe, ka humbur mundësitë për zhvillim për shkak të pushtimit të tregut nga oligarkia e lidhur me Edi Ramën. Vendin e sipërmarrjes së ndershme në treg po e zënë banditët me paratë e tyre të drogës e krimit. Sipërmarrja vuan çdo ditë dhunën fiskale, gjobëvënëse dhe korruptive të burokracisë inspektuese banditeske-politike të Edi Ramës. Investimet e huaja janë në rënie pas mbarimit të disa projekteve të mëdha të trashëguara nga qeverisja demokrate. Të huajt që tentuan të investojnë në Shqipëri u goditën nga sistemi oligarkbanditesk i Rilindjes. Ata janë larguar dhe po vazhdojnë të largohen. Investitorë të rinj të mëdhenj nga Perëndimi as që po duken. Me përfundimin e TAP dhe Kaskadës së Devollit dhjetëra mija shqiptarë do t'i humbin vendet e punës", tha Basha.

Të mërkurën Maqedonia nënshkruan protokollin për anëtarësim në NATO

Shkup, 1 shkurt - Të mërkurën, më 6 shkurt, Maqedonia e përfaqësuar nga ministri i Jashtëm, Nikolla Dimitrov, në një ceremoni zyrtare do ta nënshkruajë protokollin për anëtarësim në NATO, duke cituar burimet e NATO-s.

Teksti i protokollit tashmë është miratuar në të ashtuquajturën procedurë të heshtur ditën e hënë. Të mërkurën duhet të nënshkruhet nga Dimitrovi dhe ambasadorët e shteteve anëtare, ndërsa në periudhën e ardhshme dokumenti duhet të ratifikohet nga secili shtet anëtar veç e veç.

Kështu, Maqedonia do të ketë të drejtë të marrë pjesë në të gjitha takimet në të gjitha nivelet e aleancës, por nuk do ta ketë të drejtën e votimit derisa të bëhet anëtare e plotë.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Arrihet marrëveshja në mes të drejtuesve të shtetit dhe drejtuesve të SBAShK-ut për ndërprerjen e grevës në arsim

Pas tri javë grevë, të hënën nis procesi mësimor

Nxënësit dhe mësimdhënësit, pas një greve trejavëshe, do t'i kthehen procesit mësimor të hënën. Marrëveshja për ndërprerjen e grevës në arsim është arritur të premten në takimin e përbashkët të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryeministrit Ramush Haradinaj dhe kryetarit të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), Rrahman Jasharaj. Me këtë rast kreu i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, ka thënë se marrëveshja parasheh rritjen e pagave përafërsisht në nivelin që e kanë kërkuar mësimdhënësit, deri në 30 për qind

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 1 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj të premten kanë arritur marrëveshje me kryetarin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), Rrahman Jasharaj, për ndërprerjen e grevës në arsim. Pas tri javë greve procesi mësimor do të fillojë të hënën (4 shkurt) meqë sindikalistët e arsimit janë pajtuar me ofertën e institucioneve për rritjen e koeficientit të pagave që pritet të zbatohet përmes Projektligjit për paga i cili do të mundësojë edhe rritjen e pagave përafërsisht në nivelin që e kanë kërkuar mësimdhënësit, deri në 30 për qind.

Në një konferencë të përbashkët për media, kryeparlamentari Kadri Veseli është shprehur i lumtur që nxënësit e Kosovës dhe mësimdhënësit nga e hëna do t'u kthehen shkollave. Ai ka thënë se me këtë marrëveshje të gjithë punëtorëve në sistemin e arsimit do t'u rriten pagat, kurse premtimet do të mbahen edhe për sektorët e tjerë. "Nesër (e shtunë) në Kuvendin e Kosovës do ta miratojmë Projektligjin për paga, i cili do të mundësojë rritjen e pagave për më shumë se 70 mijë punonjës të sektorit publik. Ashtu siç u kemi premtuar, pagat do t'u rriten të gjithëve: policisë, ushtrisë, shëndetësisë, arsimit, artistëve, administratës publike, asamblistëve të komunave, pensionistëve dhe gjithë punëtorëve të tjerë", ka deklaruar Veseli.

"Projektligji për paga i jep vulë reformës në shëndetësi me rritjen më të lartë për personelin shëndetësor në 20 vjetët e fundit. Pagat e punëtorëve shëndetësorë bëhen më të lartat në rajon dhe kështu kthejmë tërë vëmendjen për pacientin", ka thënë kryeparlamentari Veseli. Po ashtu, ai ka bërë me dije se në takimin e së premtes me kryeministri Haradinaj janë pajtuar që punëtorëve të Doganave dhe të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) të mos u preket statusi i tyre.

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se Qeveria e Kosovës është e interesuar t'u japë përgjigje të gjitha kategorive që paguhen nga paratë e shtetit. "Jemi para votimit të Projektligjit për paga, një projektligj që e kemi pritur dhe që nuk e kemi pasur për 20 vjet. Unë jam i vetëdijshëm që përgatitja për këtë projektligj dhe puna që ka ndodhur rreth tij ka shqetësuar të gjitha kategoritë që paguhen nga buxheti. Ne nuk i kemi keqkuptuar asnjëherë shqetësimet e tyre, por i kemi mirëpritur ato shqetësime. Mendoj se ne kemi arritur finalen e këtij projektligji", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se arritja e kësaj marrëveshje nuk ka qenë e mundshme me Sindikatën e SBAShK-ut pa ndihmën e kryetarit Veseli dhe ndihmën e kryetarit të Komisionit për Administratë Publike, Nait Hasani. "Nuk ka qenë e lehtë as marrëveshja e sotme pa ndihmën e kryetarit Veseli. Është e ditur që qeveria e vendit është e interesuar t'u japë përgjigje të gjitha kategorive që paguhen nga paratë e shtetit. Jemi të interesuar të respektohet integriteti i të gjithëve në Kosovë, prandaj falënderoj shumë Sindikatën. I kemi edhe sfidat, por që ju siguroj se do të respektohet dinjiteti i të gjithëve në Kosovë. Nuk është në interesin e askujt që cilado kategori të mos respektohet në kategorinë e vet", ka theksuar Haradinaj.

Ndërsa kryetari i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, është ndarë i kënaqur me arritjen e marrëveshjes për ndërprerjen e grevës dhe rritjen e koeficientëve për punëtorët në sistemin arsimor. Ai ka thënë se marrëveshja e arritur nuk është idealja, por është afër realizimit të kërkesave të sindikalistëve. "Është tepër, tepër afër 30 përqindëshit. Nuk është 30 për qind por, kur ka dialog, kur ka negocime, duhet bërë edhe kompromise. Fitues jemi të gjithë. Është një marrëveshje e mirë, sepse ka lëvizje të koeficientëve dhe angazhimi ynë që të mos jemi mes rangimit një e dy, tani me këto lëvizjet e reja, sistemi para universitar, çerdhet dhe të tjerat kalojnë nga koeficienti dy në tre dhe kjo është një arritje, që e konsiderojmë të mirë", ka thënë Jasharaj. Ai ka konfirmuar që mësimi do të fillojë të hënën pavarësisht nëse Projektligji për paga do të votohet të shtunën apo shtyhet për ndonjë ditë tjetër pasi, sipas tij, sindikata ka arritur qëllimin e saj që koeficientët e rritur të jenë pjesë e këtij projektligji. "Patjetër që mësimi do të nisë të hënën, sepse ky projektligj e mbërthen fatin e të gjithëve kurdo që votohet. Angazhimet tona dhanë fryte ngaqë në Projektligjin për paga jemi më mirë sesa që ishim dhe unë besoj se deputetët karshi Ligjit për buxhet do ta votojnë edhe Projektligjin për paga", është shprehur ai.

Ndërkohë sot (e shtunë) në Kuvendin e Republikës së Kosovës pritet të miratohet Projektligji për paga i cili do të mundësojë rritje të pagave për më shumë se 70 mijë punonjës të sektorit publik.

Flet për "Epokën e re", Ismajl Kurteshi

Taksa duhet të mbetet,

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka thënë se taksa ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës duhet të mbetet në fuqi, kurse qeveria duhet të bjerë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se qeveria duhet t'ua sqarojë ndërkombëtareve se taksa nuk është pengesë për vazhdimin e dialogut në mes të dy shteteve. Kurteshi e ka mohuar mundësinë që vendi të ketë një qeveri gjithëpërfshirëse. Sipas tij, e vetmja zgjidhje për vendin janë zgjedhjet e parakohshme

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 SHKURT - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ismajl Kurteshi, ka ftuar Qeverinë e Kosovës të mos lëvizë nga taksa për mallrat serbe. Ai ka thënë se taksa duhet të mbetet në fuqi dhe qeveria duhet të bjerë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kurteshi ka vlerësuar se qeveria duhet t'ua sqarojë ndërkombëtareve se taksa nuk duhet të jetë pengesë për vazhdimin e dialogut në mes të dy shteteve. "Mendoj se nuk duhet të hiqet dorë nga taksa, por duhet t'i bindim miqtë tanë ndërkombëtarë që taksa nuk është pengesë për bisedime. Ne mund të bisedojmë edhe duke qenë taksa në fuqi", ka thënë Kurteshi. Ai ka vlerësuar se çdokush duhet ta dijë se pengesë për arritjen e marrëveshjes historike në mes të dy vendeve janë sjelljet e Serbisë. "Pengesë për mosarritjen e një marrëveshje në mes të dy vendeve janë sjelljet destruktive të Serbisë ndaj Kosovës. Serbia udhëheq një politikë hegjemoniste ndaj Kosovës. Ajo ka bërë shkelje shumë të mëdha", është shprehur Kurteshi. Sipas tij, vendi ka nevojë për zgjedhje të reja. "Vetëvendosje mendon se zgjidhja është shkuarja në zgjedhje të reja, ku do të ndodhte një legjitimim i ri i subjekteve që i fitojnë ato zgjedhje, pastaj të cilat do të duhej të marrin vendime në lidhje me marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Natyrisht se ato bisedime duhet t'i zhvillojë qeveria e re, e cila del pas zgjedhjeve, dhe jo presidenti i vendit", ka deklaruar Kurteshi.

Deputeti i LV-së ka treguar se këtë qeveri PDK-ja do ta rrezojë sapo i konvenon asaj. "Në momentin që PDK-ja e konsideron të përshtatshme për ta bërë një gjë të tillë, ajo e bën. PDK-ja nuk e rrëzon qeverinë për punën e taksës, por kur mendon se do t'i fitojë zgjedhjet prapë. Por, besoj se moment të tillë më nuk do të ketë, edhe nëse ky mandat zgjat deri në fund, sepse tanimë nuk ka subjekt që nuk e ka provuar koalicionin me PDK-në, përveç LV-ja e cila ka qëndrimin e qartë për këtë çështje", ka thënë Kurteshi. Ai ka treguar se ky subjekt politik nuk do ta votojë as Projektbuxhetin për vitin 2019 dhe as Projektligjin për paga.

"Epoka e re": *Z. Kurteshi, të shtunën pritet të votohet projektbuxheti. A do ta votojë Lëvizja Vetëvendosje këtë projektligj?*

Kurteshi: Lëvizja Vetëvendosje ka shumë vërejtje për buxhetin e vitit 2019. Ne kemi bërë disa propozime, por alternativat tona nuk kanë kaluar, prandaj buxhetin, kështu siç është, Lëvizja Vetëvendosje nuk do ta votojë.

"Epoka e re": *Në këtë ditë pritet të votohet edhe Projektligji për pagat. Cilat janë vërejtjet e LV-së për këtë projektligj?*

Kurteshi: Qëndrimi ynë është i njohur për publikun. Kosova ka nevojë shumë për një ligj të tillë sepse me një ligj të tillë ndërpritet zhvatja e buxhetit që ka ndodhur nga të ashtuquajturat institucione të pavarura dhe bordet, të cilat vetëm e kanë zhvatur buxhetin, por nuk kanë dhënë asnjë kontribut tjetër. Por, mënyra se si është hartuar ky projektligj nuk është bërë ashtu siç është dashur. Projektligji është i nevojshëm, por ai është dashur të hartohet ndryshe. Është dashur që së pari të përcaktohet koeficienti për grupe të ndryshme, pastaj t'i jepet vlera koeficientit. Kurse tani është vepruar në të kundërtën, njëherë i është caktuar vlera koeficientit, qeveria ia ka rritur pagën vetes dhe atyre që ia ka marrë mendja, pastaj ua ka rritur pagën atyre që janë ankuar. Ndërsa në fund për shumë kategori të rëndësishme është arsyetuar se nuk ka buxhet. Natyrisht se nuk mbesin para kur nuk bëhet radhitja në një mënyrë të studiuar mirë dhe para se të caktohet vlera e koeficientit. Pra, nuk pajtohemi me këtë projektligj sepse kategori shumë të rëndësishme kanë mbetur jashtëzakonisht ulët dhe kjo jo vetëm se ka

qeveria duhet të bjerë

ngjallur pakënaqësi në mes të kategorive të caktuara, por do të ndikojë edhe në kualitetin e punës në shumë segmente të jetës sonë publike.

"Epoka e re": *Për këtë projektligj kanë reaguar disa sindikata. Disa prej tyre kanë hyrë edhe në grevë. Kanë qenë të drejta kërkesat e grevistëve?*
Kurteshi: Ne e kemi vlerësuar të drejtë reagimin dhe kërkesat e tyre, por përherë kemi tërhequr vërejtën që të arrihet marrëveshje para se të shkohet në grevë. Kemi qenë të sigurt se marrëveshja do të vijë ngaqë greva nuk mund të zgjasë pakufi. Mirëpo tani shtrohet pyetja kush është përgjegjësi për humbjen e mësimit tri javë. Pra, gjatë kësaj kohe kanë humbur mësimin mbi 450 000 shkollarë të Kosovës. Të gjitha të tjerat mund të kompensohen, kjo është e pakompensueshme. Këtu fajtori është me emër dhe mbiemër dhe për këtë dikush duhet të japë përgjegjësi. Adresa e përgjegjësisë dihet.

"Epoka e re": *Kush është përgjegjës?*
Kurteshi: Është Qeveria e Kosovës pasi i ka hyrë kësaj pune pa e analizuar mirë. Nuk është dashur të bëhen dallime të mëdha në koeficient, prej 1 deri në 12, kurse pastaj e zbriti prej 1 deri në 10. Mendoj se edhe koeficienti 10 është shumë. Pra, është dashur të shkohet prej 1 deri në 6. Mjafton që presidenti i vendit ta ketë pagën gjashtë herë më të madhe se paga minimale. Le ta rritë qeveria pagën minimale dhe pagën mesatare, në mënyrë që me automatizëm le t'u rritet edhe atyre paga. Nuk është në rregull që ata që nuk kanë bukë, të vdesin prapë të uritur, kurse këta që kanë, të marrin edhe më shumë.

"Epoka e re": *Përveç grevave, qeveria është në një presion ndërkombëtar për heqjen e taksës ndaj produkteve të Serbisë dhe të Bosnjës. Si duhet të veprojë Kosova në këtë rast, meqenëse heqjen e taksës me ngulm po e kërkojnë edhe amerikanët?*
Kurteshi: Ne mendojmë se vendosja e taksës ndaj produkteve serbe është e drejtë dhe duhet t'i bindim miqtë tanë, qoftë amerikanë, qoftë evropianë, që taksa nuk është pengesë për bisedime. Pengesë për mosarritjen e një marrëveshje në mes të dy vendeve janë sjelljet destruktive të Serbisë ndaj Kosovës. Serbia udhëheq një politikë hegjemoniste ndaj Kosovës. Ajo ka bërë shkelje shumë të mëdha. Evropa me reagimet që ka bërë në fillim ka dëshmuar se nuk është e paanshme. Kurse ShBA-ja natyrisht se është e interesuar që në Ballkan të arrihet një marrëveshje, por kjo marrëveshje mund të jetë jetëgjatë vetëm kur ajo është e drejtë dhe e pranueshme për të dyja palët. Nuk e di se si do të veprojë qeveria, mirëpo mendoj se nuk duhet të hiqet dorë nga taksa, por duhet t'i bindim miqtë tanë ndërkombëtarë që taksa nuk është pengesë për bisedime. Ne mund të bisedojmë edhe duke qenë taksa në fuqi.

"Epoka e re": *Së fundi kemi një përplasje të koalicionit qeverisës rreth taksës. Partia më e madhe e koalicionit qeverisës, PDK-ja, kërkon pezullimin e taksës, kurse kryeministri Haradinaj insiston në taksë. Besoni se kjo çështje mund ta rrëzojë qeverinë?*
Kurteshi: Z. Haradinaj si gjithë të tjerët e di se PDK-ja e ka zakon që partnerët e koalicionit t'i lë në lloç. Kur t'i duket atyre se është bërë boll, e gjen një arsye. Këtë herë e ka gjetur taksën. Herën e kaluar ka gjetur diçka tjetër. Ata që hyjnë në koalicion me PDK-në duhet t'i bëjnë llogaritë me kohë. Tani besoj se ata nuk janë të befasuar. Mendoj se tash nuk është i befasuar z. Haradinaj.

"Epoka e re": *Pra ju besoni se PDK-ja do ta rrëzojë këtë qeveri?*
Kurteshi: Në momentin që PDK-ja e konsideron të përshtatshëm për ta bërë një gjë të tillë, ajo e bënë. PDK-ja nuk e rrëzon qeverinë për punën e taksës por e rrëzon kur mendon se do t'i fiton zgjedhjet prapë. Por, besoj se moment të tillë më nuk do të këtë, edhe nëse ky mandat zgjatë deri në fund, sepse tanimë nuk ka subjekt që nuk e ka provuar koalicionin me PDK-në, përveç LV-ja e cila ka qëndrimin e qartë për këtë çështje.

"Epoka e re": *Në rast se qeveria bie, flitet për mundësinë e një qeverie gjithëpërfshirëse. Do t'i bashkohej LV-ja një qeverie të tillë?*
Kurteshi: Jo. Vetëvendosje mendon se zgjidhja është vajtja në zgjedhje të reja, ku do të ndodhte një legjitimim i ri i subjekteve që i fitojnë ato zgjedhje, të cilat do të duhej të marrin vendime në lidhje me marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Natyrisht se ato bisedime duhet t'i zhvillojë qeveria e re, e cila del pas zgjedhjeve, dhe jo presidenti i vendit.

Limaj: Dialogu me Serbinë s'ka kuptim të vazhdojë pa marrëveshje

PRISHTINË, 1 SHKURT - "Dialogu midis Kosovës dhe Serbisë, për normalizimin e marrëdhënieve, nuk ka kuptim të vazhdojë pa një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe obliguese për të dy vendet, që do të rezultojë me njohje reciproke", tha zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, njëherësh bashkëkryesues i Ekipit Negociator në bisedimet me Serbinë. Këto komente Limaj i bëri në një konferencë për media të premten në Prishtinë. "Ne po shkojmë drejt etapës së fundit të dialogut, që do të ketë marrëveshje gjithëpërfshirëse të garantuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, njohjen brenda marrëveshjes, anëtarësimin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe pranimin e Kosovës nga vendet e Bashkimit Evropian", ka thënë Limaj.
Ai dhe kryesuesi tjetër i ekipit negociator, Shpend Ahmeti, takuan këtë javë në Bruksel zyrtarë të Bashkimit Evropian për, siç u tha, rishikimin e përparimit të arritur deri më tani në dialogun për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Të premten Limaj foli edhe në lidhje me mospajtimet brenda koalicionit qeverisës në Kosovë rreth kërkesës së BE-së dhe ShBA-së për pezullimin e tarifës doganore 100 për qind, të vendosur mbi importet nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Limaj ka thënë se vendimi i Qeverisë së Kosovës për këtë taksë është vendim shtetëror dhe se "shteti do të reagojë rreth vendimeve të veta kur ta shohë të arsyeshme të reagojë".

‘Drejtësia 2020’, e përkushtuar për luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Prishtinë, 1 shkurt (ER) - Në kuadër të agjendës "Drejtësia 2020" është mbajtur takimi i radhës i krerëve të sistemit të drejtësisë, përkatësisht ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, kryesuesit të Këshillit Gjyqësor, Nehat Idrizi, si dhe kryesuesit të Këshillit Prokurorial, Bahri Hyseni, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Zyrës së BE-së në Kosovë dhe përfaqësuesve të Ambasadës së ShBA-së.

Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, kryetarët e gjykatave ku ndodhen rastet e shënjestruara, si dhe koordinatorët e prokurorisë dhe gjyqësorit për këto raste. Temë e këtij takimi ishte vlerësimi i progresit në zgjidhjen e lëndëve të shënjestëruara që ndërlidhen me liberalizimin e vizave si dhe inkurajimi për rritjen e efikasitetit për trajtimin e këtyre lëndëve. "Rritja e efikasitetit për trajtimin e rasteve të shënjestruara duhet të vazhdojë me intensitetin e njëjtë, në mënyrë që luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit të jetë i matshëm dhe në funksion të fuqizimit të sundimit të ligjit si dhe arritjes së kredencialeve të plota në procesin e liberalizimit të vizave", u tha në takimin e Bordit të "Drejtësisë 2020".

Në kuadër të kësaj agjende që synon rritjen e efikasitetit brenda sistemit gjyqësor dhe prokurorial për fuqizimin e sundimit të ligjit, në funksion edhe të proceseve që ndërlidhen me liberalizimin e vizave, krerët e sistemit të drejtësisë kanë konfirmuar përkushtimin për luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. "Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është prioritet themelor i institucioneve dhe organeve të pavarura të zbatimit të ligjit. Qasja kundër veprave penale të kësaj natyre do të vazhdojë të jetë në qendër të

veprimtarisë së institucioneve të sistemit të drejtësisë, gjë që do të reflektohet me fuqizimin e sundimit të ligjit, rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe në proceset e tjera të rëndësishme për Republikën e Kosovës siç është liberalizimi i vizave", vlerësuan krerët e agjendës "Drejtësia 2020".

Gjatë takimit, bartësit e institucioneve të sistemit të drejtësisë vendosën që gjatë muajit shkurt të prezantojnë një raport të përgjithshëm mbi përparimin e arritur në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit nëpërmjet të cilit vendet e Bashkimit Evropian do të njoftohen mbi ecurinë dhe progresin e arritur, me theks të veçantë për trajtimin e rasteve të shënjestruara.

Koordinatori Hoti nis bashkëpunimin me institucionet e arsimit të lartë

Prishtinë, 1 shkurt (ER) - Në kuadër të zyrtarizimit të bashkëpunimit me institucionet e larta për përfshirjen e studentëve në Programin Nacional për Rininë, koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me rektorin e Kolegjit AAB, Lulzim Tafa. Ky program parasheh përfshirjen e rreth 110 000 studentëve nga të gjitha universitetet dhe kolegjet e Kosovës në garën e sportit dhe kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik. "Programi Nacional për Rininë është hartuar ekskluzivisht për nxënës dhe studentë i cili do t'ua krijojë atyre hapësirën dhe frymën garuese që deri më tani u ka munguar. Për herë të parë një program i tillë është hartuar në nivel qeveritar, çfarë do të thotë

se Qeveria ka kthyer vëmendjen aty ku duhet. Studentët do të kenë mundësi t'i tregojnë aftësitë e veta sportive dhe kreative dhe më të mirët e këtyre fushave do të shpërblehen", ka thënë koordinatori Hoti.

Ndërkaq rektori i Kolegjit AAB, Lulzim Tafa, u shpreh i lumtur që në cilësinë e rektorit po e përkrah një program që Qeveria ua ofron studentëve. "Ne jemi të gatshëm ta mbështesim këtë program i cili sigurisht se do t'i ndihmojë studentët tanë dhe do të ndikojë pozitivisht tek ta. Do t'ju përkrahim edhe në mënyrë vullnetare për aktivitetet e juaja edukative për nxënës dhe studentë", ka thënë Tafa.

Marrëveshja e bashkëpunimit e nënshkruar ndërmjet koordinatorit Hoti dhe rektorit Tafa përcakton angazhimet e ndërsjella të palëve nënshkruese për implementimin e Programit Nacional për Rininë dhe për organizimet e përbashkëta të aktiviteteve që kanë të bëjnë me përfshirjen e studentëve në garat e kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik si dhe të sportit.

Operacion i përbashkët i ekspertëve amerikanë dhe të FSK-së për shkatërrimin e mjeteve eksplozive

Prishtinë, 1 shkurt (ER) - Specialistët e Ekipeve për Eliminimin e Mjeteve të Pashpërthyera Eksplozive (EOD) të Kompanisë së Çminimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), në bashkëpunim me specialistët e Ekipit të EOD-së nga kampi amerikan "Bondsteel", kanë realizuar një operacion të përbashkët për shkatërrimin e mjeteve eksplozive të cilat janë gjetur nga ekipet e EOD-së në rajone të ndryshme të Kosovës. Në këtë operacion janë demoluar 16 mjete të kalibrave të ndryshëm të cilat kanë qenë rrezik permanent për jetën e qytetarëve. Demolimet janë realizuar në fshatin Halilaq, të organizuar në dy cikle. Operacioni i demolimit ka shkuar sipas planifikimit dhe është realizuar me sukses.

Është mbajtur takimi i parë i Komisionit Ndërministror për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz

Limaj: Kompleksi Memorial në Prekaz, prioritet i Qeverisë

"Prekazi është historia e rrugëtimit të kombit tonë ndër shekuj deri te ardhja e lirisë, prandaj duhet t'ia japim përkushtimin që e meriton", ka deklaruar të premten zëvendëskryeministri Fatmir Limaj pas takimit të parë të Komisionit Ndërministror për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Limaj ka thënë se Qeveria e Kosovës ka prioritet të veçantë Kompleksin Memorial në Prekaz për shkak të gjendjes jo të mirë

EPOKA E RE Faton DERMAKU

Prishtinë, 1 shkurt - Kryesuar nga zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, të premten është mbajtur takimi i parë i Komisionit Ndërministror për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, pjesë e të cilit janë edhe disa ministra të kabinetit qeveritar, kryetari i Komunës së Skenderajt dhe përfaqësues të instituteve në Kosovë. Me këtë rast zëvendëskryeministri Limaj ka thënë se themelimi i këtij Komisioni tregon se Qeveria e Kosovës ka vendosur t'i japë prioritet të veçantë çështjes së Kompleksit Memorial "Adem Jashari". Ai ka treguar se gjendja jo e mirë dhe e rrezikshme në këtë kompleks ka bërë që të ngrihet vetëdija e të gjitha institucioneve për t'u marrë seriozisht me këtë çështje. Sipas Limajt, Prekazi është vetë historia e rrugëtimit të kombit tonë ndër shekuj deri te ardhja e lirisë, prandaj duhet t'ia japim përkushtimin që e meriton. "Ne besojmë se nuk ka gjë më të rëndësishme për ne si trashëgimi e jona historike sesa Kompleksi Memorial në Prekaz. Është shenjë e lirisë sonë, pjesë e pandashme e jetës sonë, krenarisë, dhimbjes dhe vuajtjes. Prekazi është vetë historia e rrugëtimit të kombit tonë ndër shekuj deri tek ardhja e lirisë, prandaj duhet t'ia japim përkushtimin që e meriton", ka deklaruar Limaj, duke shtuar se Qeveria e Kosovës është e vendosur të përfundohet sa më shpejt edhe konservimi edhe përfundimi i projektit.

Zëvendëskryeministri Limaj është shprehur i sigurt se në përfundim të këtij projekti të gjithë do të ndihen krenarë me punën që do të bëhet. Me gjithë punën komplekse dhe të madhe që pritet të bëhet, zëvendëskryeministri Limaj ka theksuar se janë të vendosur që t'i shkojnë deri në fund këtij projekti ngaqë Prekazi, si vend i shenjtë jo vetëm i Kosovës, por i gjithë shqiptarëve, e meriton një projekt të tillë.

Ndërsa kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka falënderuar të gjithë anëtarët e komisionit për punën, duke uruar fillimin e projektit në Kompleksin Memorial "Adem Jashari". Me këtë rast ai ka thënë se është konfirmuar edhe një herë prioriteti i Qeverisë së Republikës së Kosovës për ta përfunduar projektin e nisur në vitin 2005, për këtë vend të shenjtë të Kosovës, ku kanë rrënjë liria dhe pavarësia e saj. "Jam i sigurt se me përfundimin e projektit për Kompleksin Memorial 'Adem Jashari' qytetarëve nga mbarë trevat shqiptare, por jo vetëm, do t'u mundësohet të kenë një kompleks atraktiv që ia vlen të vizitohet", ka deklaruar Jashari.

Nga e hëna fillon procesi i organizimit të provimeve në UP

Prishtinë, 1 shkurt (ER) - Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur të premten, ka diskutuar çështjen e organizimit të afatit të provimeve të janarit në njësitë akademike të UP-së. "Në këtë takim senatorët u pajtuan që nga e hëna të fillojë procesi i organizimit të provimeve si në afatet kohore në vijim: SEMS-i për paraqitje të provimeve do të jetë i hapur më datat 4 dhe 5 shkurt 2019; Datat e mbajtjes së provimeve: 6 shkurt 2019 deri më 28 shkurt 2019 (përjashtim nga këto data bëjnë ditët e festave zyrtare). Si rrjedhojë e kësaj, obligohen dekanët e njësive akademike që t'i riorganizojnë datat e provimeve për javët e humbura, sipas specifikave të njësive përkatëse. Po ashtu, informoheni se semestri veror për vitin akademik 2018-2019 në UP fillon më 25 shkurt 2019. Senati i Universitetit të Prishtinës u uron studentëve sukses në këtë afat të provimeve!", është bërë me dije në njoftimin e UP-së.

Hapet një pikë e re e Qendrës së Mjekësisë Urgjente në Prishtinë

Prishtinë, 1 shkurt (ER) - Qendra e Mjekësisë Urgjente ka hapur një pikë të re në kryeqytet, për ta rritur efikasitetin e punës dhe për ta shpejtuar edhe më shumë kohën e intervenimit. Pika e re është vendosur në hapësirat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe do të ofrojë shërbime 24 orë gjatë tërë javës. "Mesatarja e shpejtësisë së reagimit aktualisht është 6 minuta nga momenti i thirrjes, por me hapjen e pikës së re pritet të bjerë edhe më tutje", është bërë me dije në njoftimin për media të Komunës së Prishtinës.

Sot mbahet seanca për votimin e buxhetit

Prishtinë, 1 shkurt - Sot (e shtunë), në orën 10:00, Kuvendi i Kosovës do të mbajë seancë plenare, në të cilën do të jenë nëntë pika për votim nga deputetët. Në këtë seancë do të jetë edhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019. Po në këtë seancë plenare do të bëhet edhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura; shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zyrtarët publikë; shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pagat në sektorin publik; shqyrtimi i parë i Projektligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë; shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122 si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256; propozimi për formimin e komisionit Ad Hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe përfitimeve nga sigurimi social; shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr. 06/L-20 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018; dhe shqyrtimi i propozim-statutit të shoqërisë aksionare "Trepça" Sh.A.

Ministri Jagxhillar: Depolitizimi dhe transparenca pjesë e reformës për administratën publike

Prishtinë, 1 shkurt (ER) - Administrata Publike e Kosovës është shtylla kryesore e një shteti demokratik, ndërkaq pa një administratë publike moderne, profesionale dhe llogaridhënëse, nuk mund të ofrohen shërbime efikase. Kështu ka deklaruar të premten në Kolegjin UBT, ministri i Ministrisë së Administratës Publike, Mahir Jagxhillar, në një ligjëratë me temën "Modernizimi i administratës publike në Kosovë: sfidat dhe mundësitë".

Ministri Jagxhillar ka potencuar se modernizimi i administratës në Kosovë nënkupton më tepër depolizitim, njëherësh përfshinë llogaridhënie dhe profesionalizëm. "Strategjia për zgjerim e Bashkimit Evropian e publikuar në shkurt të vitit të kaluar thekson se reforma e administratës publike është me rëndësi për forcimin e qeverisjes në të gjitha nivelet. Kjo përfshin përmirësimin e cilësisë dhe llogaridhënies së administratës, rritjen e profesionalizmit, depolitizimin dhe transparencën", ka thënë ai.

Ministri Jagxhillar ka shtuar se procesi i reformave të Administratës Publike përcillet edhe me sfida të shumta, por se transformimi i këtij sistemi është një investim në demokraci dhe ekonomi. "Koordinimi ndërinstitucional më efikas, rritja e llogaridhënies në administratën publike, rishikimi funksional i të gjitha organeve qendrore dhe të pavarura me opsione të qarta për racionalizimin e tyre, sistem efektiv të raportimit në kohë reale bazuar në të dhëna reale, janë vetëm disa prej sfidave me të cilat po përballet ky sistem", ka thënë ministri Jagxhillar.

Në bashkëbisedim me studentët e UBT-së, rektori prof. dr Edmond Hajrizi ka thënë se strategjia për modernizimin e administratës publike e Qeverisë së Kosovës, e cila do të përfundojë në vitin 2020, është politikë e rëndësishme që ndihmon vendin edhe në procesin e integrimit evropian. Hajrizi ka potencuar se UBT-ja ka përfituar shumë nga ekspertiza e vendeve të tjera dhe me këtë rast si institucion, studentët dhe stafi akademik mund të kontribuojë në këtë proces.

Në fund u tha se modernizimi i administratës publike në Kosovë përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve dhe afron shtetin e Kosovës me shtetet e tjera të Bashkimit Evropian.

Shala: Kosovës po i vjen një investim i huaj në vlerë prej 169 milionë eurosh

Prishtinë, 1 shkurt (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka bërë me dije të premten se për herë të parë Komisioni për Investime Strategjike ka dhënë rekomandimin për dhënien e statusit të investitorit strategjik kompanisë 'Sowi Kosovo LLC' nga Qeveria e Republikës së Kosovës. "Kosovës po i vjen investimi i huaj direkt më i madh që nga pas lufta, në vlerë prej 169 milionë eurosh", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala.

KDI-ja: Vonesa të mëdha dhe parregullsi për dhënien e kontratës për mirëmbajtje të rrugëve

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 SHKURT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar të premten analizën "Mirëmbajtja problematike e rrugëve, vonesat dhe favorizimet", që shpërfaq gjetjet nga monitorimi i kontratës trevjeçare të Ministrisë së Infrastrukturës për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës (2017-2019). Në hapje të kësaj tryeze, Arben Kelmendi, menaxher i Programit në KDI, ka treguar që ky raport paraqet gjetjet nga monitorimi proaktiv i prokurimit publik në Ministrinë e Infrastrukturës (MI).

Kurse Fjolla Uka, hulumtuese në KDI, ka bërë me dije se është analizuar procesi i prokurimit të kësaj kontrate, duke filluar nga faza e planifikimit, faza e tenderimit, kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, faza e shpërblimit si dhe ankesat e operatorëve dhe vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OShP) lidhur me këto ankesa. Ajo ka vënë theksin në stërzgjatjen e dhënies së kontratës nga MI-ja për më shumë se një vit si rrjedhojë e ankesave të shumta të operatorëve ekonomikë lidhur me vendimet e kësaj ministrie për dhënie të kontratës.

Uka ka theksuar se për shkak të mosshqyrtimit adekuat të ankesave nga ana e MI-ja këta operatorë kanë deponuar ankesa në OShP dhe kjo ka ndikuar në zgjatjen e procesit të prokurimit e, si rrjedhojë, edhe mbetjen e rrugëve pa mirëmbajtje. "Shumë ankesa të refuzuara nga MI-ja si të pabazuara janë aprovuar nga OShP-ja si të bazuara. Vonesat për dhënien e kontratave e kanë detyruar MI-në të lidhë kontratë emergjente për mirëmbajtjen dimërore, me çmim më të lartë për 289 326.27 euro krahasuar me çmimin që do ta paguante sipas kontratës së rregullt", është shprehur Uka.

Gjetje tjetër e këtij raporti është edhe fakti që Ministria e Infrastrukturës qysh nga viti 2014 deri në vitin 2020 ka nënshkruar kontrata me operatorët e njëjtë ekonomikë. Gjetje tjetër shqetësuese e këtij raporti janë edhe çmimet e ofertuara nga operatorët ekonomikë fitues. Gjetjet e raportit apelojnë që planifikimi i procesit të prokurimit për mirëmbajtje të rrugëve të bëhet me kujdes, ndërsa procedurat e tenderimit të fillojnë me kohë. Po ashtu, njoftimet për aktivitete prokuruese duhet të publikohen në platformën e e-prokurimit konform kërkesave ligjore.

Gjithashtu, KDI-ja rekomandon që kriteret e vendosura në dosjen e tenderit të caktohen konform normave ligjore, në mënyrë që të mos dalin më pas ankesa që mund të ndikojnë në besueshmërinë, por edhe në vonesën e procesit të tenderimit.

Më tej, në raport theksohet se Ministria e Infrastrukturës konform rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik te kontratat me çmime për njësi duhet ta përdorë metodën e poentimit, e që në kontratën konkrete të shqyrtuar në këtë raport nuk është përdorur.

KDI-ja kërkon që Ministria e Infrastrukturës t'i respektojë vendimet e OShP-së dhe t'i kthejë asaj përgjigje brenda afateve ligjore. Sipas KDI-së, OShP-ja duhet ta penalizojë ose të nxjerrë urdhër ndaj Autoritetit Kontraktues i cili nuk i respekton vendimet e saj dhe nuk është bashkëpunues gjatë kohës kur ndonjë aktivitet është në procedurë në OShP.

Ky raport është pjesë e projektit për monitorimin e prokurimit publik në institucionet publike si Ministria e Infrastrukturës, Shëndetësisë, Autoriteti Qendror i Prokurimit dhe Korporata Energjetike e Kosovës dhe financohet nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

Inspektorët e ushqimit, të pakënaqur me Projektligjin për paga

PRISHTINË, 1 SHKURT (ER) - Punonjësit e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë janë të pakënaqur dhe ndihen të fyer me kategorizimin në ligjin e pagave. Kështu është bërë me dije në një njoftim për media nga kjo agjenci.

Agjencia se Ushqimit dhe Veterinarisë ka kërkuar nga komisioni parlamentar për rregullimin e çështjes së koeficienteve për këta punëtorë. "Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë e përbëjnë punonjës me profesione mjek të mjekësisë veterinare të cilët duhet të klasifikohen në stafin 'profesional' ku janë të renditur edhe mjekët e mjekësisë humane sipas koeficienteve të përcaktuar në ligjin e lartshënuar. Inspektorët e ushqimit, të shëndetit të kafshëve, të shëndetit të bimëve dhe punonjës të laboratorit të ushqimit janë kategorizuar më së keqi brenda ligjit", është thënë në njoftimin për media.

AUV-ja ka theksuar se nëse kërkesa e tyre nuk do të merret parasysh nga komisioni parlamentar dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, atëherë do të jenë të detyruar të hyjnë në grevë.

Republika e Kosovës
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë

Për një muaj, 170 të akuzuar nga Prokuroria në Gjakovë

Gjakovë, 1 shkurt (ER) - Në Prokurorinë Themelore në Gjakovë gjatë muajit janar 2019 janë ngritur 131 aktakuza kundër 170 personave për vepra të ndryshme penale. Në Departamentin e Krimeve të Rënda gjatë kësaj periudhe janë ngritur pesë aktakuza kundër nëntë personave, gjithashtu i njëjti departament ka bërë dy kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit. Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie ka ngritur 126 aktakuza kundër 161 të pandehurve, po ashtu ka bërë tetë kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit. Departamenti për të Mitur, në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, ka bërë tri propozime për masë edukative.

Klina bëhet me bust të Skënderbeut

Klinë, 1 shkurt (ER) - Në qendër të qytetit të Klinës është zbuluar të premten busti i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. "Nëse një vepër jeton pas protagonistit, nënkupton se ajo vepër ka qenë e madhe. Nëse ka një vepër e shqiptarëve që ka jetuar pas jetës së protagonistit, ajo është vepra, është lufta dhe është trashëgimia e doktrina të cilën e ndërtoi dhe e zbatoi kryeheroi ynë për të cilin jemi bashkuar sot, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në akademinë dedikuar 575-vjetorit të Lidhjes së Lezhës të mbajtur në Klinë.

Duke kujtuar kohën e Skënderbeut dhe udhëheqjen e tij, kryeministri Haradinaj ka thënë se Skënderbeu jo çdoherë u mbështet në atë kohë, por qëndroi me prijësit e vet shqiptarë dhe se, falë kësaj qëndrese, ajo që krijoi ai dhe ajo që e krijuan shqiptarët nën udhëheqjen e tij, sot vlerësohet lart nga i gjithë kontinenti ynë dhe nga të gjitha ata që i studiojnë këto procese kaq të mëdha.

Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, ka thënë se në këtë ngjarje të madhe kanë vendosur ta sjellin në qytetin e tyre të lartësuar në bronz bustin e kryeheroit të kombit, Gjergj Kastriotin Skënderbeun, i cili përfaqëson figurën më emblematike të historisë sonë.

Edhe në Vushtrri do të ndërtohen 25 shtëpi

Vushtrri, 1 shkurt (ER) - Në Komunën e Vushtrrisë do të ndërtohen 25 shtëpi për familjet që kanë nevojë. Këtë lajm e ka bërë me dije kryetari i kësaj komune, Xhafer Tahiri. Nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka shkruar se për 22 shtëpi Komuna e Vushtrrisë do të participojë me shumën prej 5 000 eurosh, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve financiare do të sigurohet nga Shoqata Humanitare "Jetimat e Ballkanit". "Komuna e Vushtrrisë është duke e shqyrtuar mundësinë që të ndajë një tokë komunale në mënyrë që të gjitha shtëpitë të ndërtohen në një lokacion. Humanisti Halil Kastrati po bën një punë të jashtëzakonshme për familjet që kanë nevojë. Prandaj në emër timin dhe të gjithë qytetarëve të Vushtrrisë dua ta shpreh mirënjohjen e falënderimet më të larta për humanistin Halil Kastrati dhe të gjithë ata që po ndihmojnë Shoqatën Humanitare 'Jetimat e Ballkanit' në këtë mision fisnik. Vetëm në vitin 2018, Shoqata Humanitare 'Jetimat e Ballkanit' ka ndihmuar me shtëpi dhe banesa 13 familje në Vushtrri", ka thënë Tahiri.

Prokuroria e Ferizajt ngre 217 aktakuza për një muaj

Ferizaj, 1 shkurt (ER) - Prokuroria Themelore në Ferizaj ka njoftuar se gjatë muajit janar 2019 ka ngrehur gjithsej 217 aktakuza për raste të ndryshme penale dhe ka paraqitur 15 kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj. Në Departamentin për Krime të Rënda janë ngrehur 13 aktakuza, janë bërë katër kërkesa për caktim të paraburgimit dhe janë marrë 15 aktvendime për fillim të hetimeve. Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie gjatë muajit janar ka ngrehur gjithsej 183 aktakuza, ka bërë nëntë kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit dhe ka marrë 80 aktvendime për fillim të hetimeve. Ndërsa Departamenti për të Mitur ka ngrehur 21 aktakuza, ka marrë 21 aktvendime për fillim të procedurës përgatitore dhe ka bërë dy kërkesa për caktim të masës së paraburgimit.

Pse po sulmohen universitetet publike?

Prof. Asoc. Dr. Bajram KOSUMI
Rektor i Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan

Nuk i vë në dyshim qëllimet fisnike të shumë kritikuesve të universiteteve publike. Edhe vetë jam një prej tyre. Por, restrikcioni, mbyllja e programeve studimore, zvogëlimi i stafit akademik nuk e ndihmojnë, përkundrazi e dëmtojnë arsimin e lartë publik. Po ashtu, nuk i vë në dyshim qëllimet jofisnike të shumë kritikuesve të tjerëve, të cilët në emër të "cilësisë" duan ta rrënojnë arsimin publik për përfitime financiare. Momentalisht, në thumb janë universitetet e reja publike, sepse ka përplasje politike rreth formimit të tyre, por goditja e vërtetë është drejt Universitetit të Prishtinës.

Njoftimi i Agjencisë së Akreditimit për mbylljen e shumë programeve studimore në universitetet publike dhe reagimi i Konferencës së Rektorëve, i nxori edhe më shumë në sipërfaqe këto prirje. Ky diskutim është hapur dhe mirë është të rrjedhë. Dihen disa gjëra, por nuk dihen detajet. E dreqi fle në detaje. Ja disa prej tyre.

Formimi i universiteteve të reja publike. Formimi i universiteteve të reja publike ende vazhdon të jetë argument i përplasjeve politike rreth arsimit të lartë. Universitetet ende vlerësohen me shijen e "formimit politik të tyre". Janë dy argumente që e bëjnë demode këtë qasje: 1. Formimi i çdo universiteti publik është në esencë akt politik (qeveria propozon, kuvendi miraton), edhe nëse është bërë në kohë fushatash zgjedhore, përsëri Kuvendi i Kosovës ka votuar themelimin dhe kjo mbyllë çdo qasje partiake; 2. Për pesë vjet punohet në universitetet e reja, qindra profesorë dhe rreth tridhjetë mijë studentë i ndërtojnë çdo ditë, ndërsa kritikuesit nuk duan ta shohin punën dhe mundin e këtyre dhjeta mijëra njerëzve!Me të vërtetë mendon dikush se për inate politike të stilit "kush i krijoi" mund të luhet me fatin e tridhjetë a katërdhjetë mijë vetave? Dhe me pritjet e familjarëve e shpresat për punë të këtyre mijëra studentëve?

Kjo qasje dilematike rreth universiteteve të reja ka ndikuar që qeveria e Kosovës, pra MAShT-i, të mos ketë asnjë herë një strategji për zhvillimin e tyre, të mos angazhohet për zhvillimin e tyre dhe ta pengojë zhvillimin e tyre. Kjo ka ndikuar thelbësisht në ritmin e zhvillimit të universiteteve. Besoj së do t'i bënte mirë çështjes diskutimi i mirëfilltë, por jo fushatat denigruese.

Fushata për mbylljen e universiteteve të reja publike. Sidomos në dy vjetët e fundit kjo qasje kulmoi. Nuk pati debat asnjë herë. Në vend të debatit pati fushata për mbylljen e universiteteve të reja. U themelua një grup (formal a joformal?) i cili pa u takuar me profesoratin universitar dhe udhëheqjen e universiteteve publike, hartoi një dokument në të cilin sollën dy propozime: i pari qe reduktimi-mbyllja e universiteteve publike, duke lënë vetëm dy, Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Dukagjinit. Universitetet tjera bëheshin degë a kampuse të këtyre universiteteve.

Fatmirësisht, kjo fushatë dështoi dhe "dokumenti" mbeti i pa zyrtarizuar. Por, ajo që nuk u realizua politikisht po provohet të bëhet me "procedurë". Neni 14, prg.6 i Ligjit për Arsimin e Lartë 04/L-037 thotë: "Bartësi publik konsiderohet i licencuar, përveç nëse ai dështon në plotësimin e standardeve të AKA-së për akreditim institucional." Si do të shohim më poshtë, Agjencia e Akreditimit u instrumentalizua për mbylljen e universiteteve të reja.

Se qeveria, në radhë të parë MAShT-i, nuk i përkrahu, përkundrazi e pengoi zhvillimin e universiteteve, fatkeqësisht ka plotë fakte: MAShT-i nuk i miratoi dhe procedoi në Kuvendin e Kosovës statutet e universiteteve; nuk ndihmoi pavarësimin e universiteteve dhe ato ende vazhdojnë të jenë pjesë e MAShT-it dhe nën-kode buxhetore të tij; u pengua në shumë mënyra burokratike procedura e "marrjes së lejes" për pranimin e stafit akademik dhe administrativ në universitete etj.

Kjo qasje është tejet jokorrekte. Janë vënë në lojë fati i rreth tridhjetë mijë studentëve dhe të qindra profesorëve. Janë vënë në karrigen e mashtruesit rektori, profesori dhe studenti: jemi apo nuk jemi universitet? Vlejnë apo nuk vlejnë këto diploma? Universitetet mbetën si peshku në grep! Këto universitete nuk mund të mbyllen politikisht. Duhet hapur debati për mundësitë e zhvillimit të tyre e jo fushata për linçimin e tyre.

Agjencia e Akreditimit është ngjitur në valle. Fatkeqësisht, Agjencia e Akreditimi u përjashtua nga EQAR pas ndërhyrjes arbitrare të qeverisë me shkarkimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Shkarkimi, pezullimi dhe emërimi i KSHC së re janë të lidhura. Qysh mund të krijohet një institucion neutral dhe i pavarur, nëse e njëjta qeveri e ka shkarkuar disa muaj më parë në mënyrë arbitrare? Çfarë garancie ka KSHC se nuk do të shkarkohet në mënyrë arbitrare përsëri nëse nuk i kryen detyrat? Votat e 77 deputetëve për KSHC-në tregojnë se të gjithë u ndërgjegjësuam për gabimin e shkarkimit, dhe tash, në stilin ballkanas, hajt ta përmirësojmë gabimin shpejt e shpejt! Emërimet e shkarkimet bëhen shpejt, por gabimet nuk korrigjohen shpejt. Me të vërtetë po mendohet se mund "ta bindim" ENQA, EQAR dhe të tjerët se AKA është e pavarur nga politika me vendimin për mbylljen e 40% të programeve studimore në universitetet e reja, po ashtu në mënyrë arbitrare?

Nuk ka asnjë dyshim, ky arbitraritet i AKA-së për mbylljen e programeve buron nga arbitrariteti i qeverisë për shkarkimin e KSHC-së në vitin 2017. Prandaj, disa anëtarë të KSHC-së kanë detyra për të bërë. Le t'i bëjnë, por nuk mund të na bindin se janë të pavarur nga politika dhe biznesi.

Që të mos keqkuptohem as nga KSHC-ja e as nga qeveria: Diskutimin për AKA-n e bëj për shkak se edhe vetë kam qenë anëtar i Këshilli Shtetëror të Cilësisë në kohën e anëtarësimit të Agjencisë në ENKA edhe EQAR.

Si i mbylli AKA programet studimore? Unë diskutoj jo të gjitha vendimet e Agjencisë, por vetëm ato për programe të cilat kanë akreditim deri në vitin 2020 e tutje.

Agjencia mund ta tërheq akreditimin një programi të akredituar në çdo kohë (si po e thotë kryetari i KSHC-së, z. Luboteni), por vetëm mbi bazën e një Raport Vlerësues i shkruar nga tre ekspertë ndërkombëtarë, i cili evidenton shkelje të kushteve të akreditimit, përshkruar në Nenin 21, prg.4 i Udhëzimit Administrativ 15/2018 (si nuk po e thotë z. Luboteni).

Agjencia bëri të kundërtën: tërhoqi akreditimet pa raport vlerësues. Ajo nuk ka kompetencë ligjore, as nuk duhet t'ia lejojë vetes që vetë, në bazë të disa listave të stafit akademik, të vlerësojë programet studimore. Agjencia duhet hapur ta pranojë gabimin, të kërkojë falje, ta rikthejë gjendjen ligjore, dhe deri sa ende nuk ka vendime të shkruar, pasojat janë më të vogla.

Shkelja e dytë është bërë me aplikimin e Nenit 26 të të njëjtit UA në mënyrë retroaktive. Deri në vitin 2018 Agjencia ka kërkuar nga universitetet tre (3) profesorë më orar të plotë për një program, ndërsa në vitin 2018 kërkon që një profesor të baras vlerësohet me 60 ECTS dhe profesori të jetë i fushës së ngushtë (Neni 26, prg. 5.3.4, UA nr. 15, 2018). Këto dy standarde mund të kërkohen për programet e reja, dhe jo në mënyrë retroaktive edhe për programet që vazhdojnë të kenë akreditim. Në praktikë këto dy standarde kanë këtë rrjedhojë: në Programin Fillor, Programin Parafillor dhe Programin Juridik i Përgjithshëm të Universitetit Kadri Zeka, duhet të rritet numri i profesorëve nga tre në katër profesorë për secilin program veç e veç. Natyrisht, në universitetin publik kjo nuk mund të bëhet për disa javë, prandaj detyrimi retroaktiv për të ndryshuar numrin e profesorëve në programet e akredituara ka de balancuar radhitjen e tyre në ato programe.

Me çdo interpretim pozitiv të ligjit, asnjë ligj nuk mund të ekzekutohen në mënyrë retroaktive, përveç kur është në favor të palës. Në këtë rast, pala është universiteti, ndërsa aplikimi retroaktiv e dëmton palën. Agjencia do të duhej pa hezitim të pranonte gabimin dhe shkeljen ligjore, ta përmirësonte gabimin dhe ta bartë një pjesë të përgjegjësisë.

Grupet e interesit politik e biznesor. Problemi i vërtetë kuptohet vetëm atëherë kur këto vendime të Agjencisë ndërlidhen me kontekstin politik dhe biznesor rreth arsimit të lartë publik në Kosovë. Janë dy procese që e shpërfaqin cullak "gabimin" e Agjencisë.

Edhe grupe të tjera të interesit, nën firmën e OJQ-ve, të cilat vegjetojnë dhe pasurohen nën kujdesin e MAShT-it që nga paslufta, kanë rol vendimtar në përcaktimin e politikave të arsimit të lartë në Kosovë. Nëse rezymojmë politikën e tyre, ajo ka këtë kuptim: është fat i mirë për Kosovën nëse Agjencia e Akreditimit i mbyllë programet studimore dhe universitetet publike. Kjo fjali e përfolur është thënë, jo një herë, publikisht. Këto grupe të interesit politik e biznesor përmes fushatave të tilla "thithin" donacione e projekte trajnuese, për të korrigjuar të metat e mëdha të arsimit të lartë publik. Në vend se të shikohen si dy aktivitete komplementare, studimi dhe trajnimi, universiteti dhe mësimi përmes trajnimit, këto grupe të interesit krijuan dy palë kundërshtuese.

Nuk duhet neglizhuar edhe një fakt të ri. Deri sa Agjencia mbylli 40% të programeve studimore në universitetet e reja publike, në kolegjet private mbylli 23% të programeve. Ditëve të fundit dolën në media fakte se Agjencia nuk ka vepruar me të njëjtat standarde ndaj të gjithëve: në të njëjtat kushte, disa programe publike i mbylli dhe disa private i akredituar. Ditëve të fundit dolën në media edhe fakte që ndërlidhin financiarisht më shumë se gjysmën e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë me një kolegj privat. Kjo na bën të dyshojmë se Agjencia e Akreditimit është në funksion edhe të grupeve të interesit biznesor.

Dhe tash, kur politikat dilematike apo edhe anti-universitet të MAShT-it dhe të grupeve të interesit politik e biznesor i shikon në kontekst të vendimit të Agjencisë së Akreditimit për mbylljen e 40% të programeve në universitetet e reja publike, kuptohet natyra e vërtetë e problemit. Agjencia nuk është e pavarur, është e ndikuar politikisht, dhe vendimi i saj për mbylljen e programeve është gabim i qëllimtë, tendencioz dhe në interes të këtyre grupeve formale e joformale politike. Agjencia ia ka hapur rrugën "procedurale" MAShT-it për të mbyllur universitetet e reja publike.

E keqja është me e madhe: këto grupe të interesit politik e biznesor synojnë Universitetin e Prishtinës. Atë ta gjunjëzojnë dhe me të, gjithë arsimin e lartë publik.

Arsimi i lartë publik duhet mbrojtur! Ka disa vjet që bëhet fushatë kundër profesoratit universitar dhe vetë universiteteve. Në emër të angazhimit për "cilësi" grupet e interesit politik e biznesor nuk lanë pa sulmuar në universitetet e Kosovës asnjë vlerë. Arsimi i lartë publik është i rrezikuar nga ndërhyrjet politike, nga interesat egoiste e jo legjitime të vet anëtarëve universitar, nga interesat e grupeve politike e biznesore, nga cilësia jo e dëshiruar etj. Kjo gjendje e padëshiruar në arsimin e lartë mund të tejkalohet vetëm me punë, me plan, me strategji, me përkrahje qeveritare dhe me vullnetin e anëtarëve universitar për progres. Kushdo që mendon e kërkon në emër të cilësisë ta mbyll e ta shkatërrojë arsimin e lartë publik, vetëm i hapë rrugë biznesit me arsimin, pra biznesit me diploma!

Mbyllja arbitrare e 40 % të programeve studimore të universiteteve të reja nuk është në asnjë rast vendim për cilësi, por vendim politik kundër arsimit të lartë publik. Beteja e vërtetë po bëhet jo vetëm për disa programe studimore, por për ruajtjen e një prej vlerave më të rëndësishme të shoqërisë sonë - arsimit të lartë publik. Tani është koha që kushdo që beson te këto vlera dhe te rëndësia e arsimit të lartë publik, ta mbrojë atë.

Pompeo: ShBA-ja tërhiqet nga Traktati i Forcave Bërthamore

Uashington, 1 shkurt - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, bëri me dije se Shtetet e Bashkuara do t'i pezullojnë obligimet e tyre me Traktatin për Forca Bërthamore me Rreze të Mesme, nisur nga 2 shkurti.

Pompeo tha të premten se Uashingtoni do ta njoftojë zyrtarisht Moskën se ShBA-ja do të tërhiqet nga traktati për gjashtë muaj. Pompeo u tha gazetarëve në Uashington se ShBA-ja mbetet e hapur për negociata me Rusinë për kontrollin e armëve. Ai tha se presidenti i ShBA-së, Donald Trump, do një marrëveshje që është e verifikueshme dhe e zbatueshme.

Pak kohë pas njoftimit të Pompeos, aleatët e NATO-s lëshuan një deklaratë, duke thënë se "e mbështesin plotësisht" vendimin e ShBA-së për t'u tërhequr nga traktati.

Uashingtoni ka paralajmëruar që disa muaj se do të dalë nga marrëveshja në fillim të shkurtit, nëse Rusia nuk e shkatërron një lloj rakete për të cilën ShBA-ja thotë se e shkel marrëveshjen. Rusia e mohon se raketa në fjalë, 9M729, e shkel Traktatin e Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme.

Traktati ShBA - Rusi, i cili daton nga Lufta e Ftohtë dhe ka eliminuar një klasë të tërë të raketave nga Evropa, konsiderohet kyç për stabilitetin strategjik në mes të Uashingtonit dhe Moskës.

Senati kundërshton tërheqjen e trupave amerikane nga Siria dhe Afganistani

Senati amerikan i udhëhequr nga republikanët miratoi projektligjin që kundërshton planet për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria dhe Afganistani dhe paraqet një kundërshtim ndaj planeve të presidentit Donald Trump për tërheqje nga këto dy shtete

Uashington, 1 shkurt - Senati amerikan, i udhëhequr nga republikanët, miratoi një projektligj, kryesisht simbolik, që kundërshton planet për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria dhe Afganistani. Projektligji paraqet një kundërshtim ndaj planeve të presidentit Donald Trump për tërheqje nga Siria dhe Afganistani. Republikanët rrallëherë marrin masa kundërshtuese ndaj presidentit Trump.

Me mbështetje të konsiderueshme nga ligjvënësit republikanë dhe demokratë, Senati më 31 janar votoi me 68 vota për dhe 23 kundër në favor të një amendamenti jodetyrues ku thuhet se Senati besonte se grupet militante islamike në të dy vendet vazhdojnë të përbëjnë një "kërcënim serioz" ndaj sigurisë së ShBA-së.

Amendamenti pranon se është bërë përparim në luftën kundër Shtetit Islamik dhe kryengritësve të Al Kaidës në të dyja vendet. Por, aty theksohet se rajoni mund të destabilizohet nëse "një tërheqje e shpejtë" ndodh pa u siguruar në masat e marra për përmirësimin e situatës, pasi do të krijohej një vakum që mund të mbushet nga Irani ose Rusia.

Legjislacioni i bën thirrje administratës së ShBA-së për t'i verifikuar kushtet që janë përmbushur për "mundjen" e grupeve militante përpara se ndonjë tërheqje e konsiderueshme e trupave të bëhet nga Siria ose Afganistani.



Projektligji u hartua nga udhëheqësi i shumicës republikane Mitch McConnell, i cili ka folur rrallë kundër presidentit Trump ose politikave të tij.

McConnell tha këtë javë se amendamenti i Senatit "do ta pranonte faktin e qartë se Al-Kaida, Shteti Islamik dhe bashkëpunëtorët e tyre në Siri dhe Afganistan vazhdojnë të përbëjnë një kërcënim serioz për kombin tonë". "Ligji do ta pranonte rrezikun e një tërheqjeje të shpejtë nga konflikti dhe thekson nevojën për angazhim diplomatik dhe zgjidhje politike për konfliktet në Siri dhe Afganistan", tha ai.

Senatori republikan Marco Rubio tha se tërheqja e planifikuar e presidentit Trump ishte një "ide e keqe".

Presidenti Trump habiti ligjvënësit e ShBA-së dhe aleatët ndërkombëtarë kur më 19 dhjetor të vitit të kaluar njoftoi se po tërhiqte të gjitha trupat amerikane nga Siria.

Ushtria amerikane atje po ndihmon një aleancë siriane-arabe dhe kurde në luftën kundër militantëve të Shtetit Islamik dhe forcave të tjera. "Ne kemi fituar kundër Shtetit Islamik dhe tani është koha që trupat tanë të kthehen në shtëpi", pati deklaruar presidenti Trump.

Presidenti Trump ka mbrojtur në mënyrë të përsëritur vendimin e tij, duke thënë se trupat fillimisht shkuan atje për tre muaj, por kanë mbetur për vite me radhë.

Zyrtarët e ShBA-së, duke përfshirë zëvendëspresidentin Mike Pence, kanë thënë se Trumpi është në "procesin e vlerësimit" nëse do të tërheqë disa trupa nga Afganistani, që kanë qenë atje që nga viti 2001.

Gjykata kërkon që Holanda të lirohet nga përgjegjësia për Srebrenicën

Hagë, 1 shkurt - Gjykatës së Lartë në Holandë iu kërkua të përmbysë një vendim që e mban këtë vend pjesërisht përgjegjës për vdekjen e rreth 300 burrave myslimanë në Srebrenicë të Bosnjës më 1995.

Prokurori i përgjithshëm i gjykatës, Paul Vlas, tha se një gjykatë holandeze e apelit më 2017 ka marrë vendim "të pakuptueshëm" duke u mbështetur në konstatimin se paqeruajtësit holandezë nuk kanë bërë mjaftueshëm për t'i mbrojtur burrat që kanë kërkuar strehim në bazën e tyre. Opinioni i prokurorit do të merret parasysh kur gjykata ta marrë vendimin përfundimtar më 19 prill.

Në total, 8 000 burra dhe djem myslimanë janë vrarë nga forcat serbe të Bosnjës, nën komandën e gjeneralit Ratko Mlladiq, në korrik të vitit 1995 në Srebrenicë.

Vrasjet janë konsideruar si masakra më e keqe në tokën evropiane që nga Lufta e Dytë Botërore. Shumë nga viktimat kanë ikur në Srebrenicë - zonë e shpallur e sigurt nga paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara - porse trupat holandeze nuk kanë qenë në gjendje t'i mbrojnë.

Qeveria e Holandës ka dhënë dorëheqje në vitin 2002, pasi ka pranuar dështimin e saj për t'i mbrojtur viktimat, por ka thënë se paqeruajtësit kanë qenë në "mision të pamundur".

Në vendimin fillestar në vitin 2014 është thënë se ushtarët holandezë duhet të dinin se burrat do të vriteshin nga forcat serbe të Bosnjës nëse do të detyroheshin të largoheshin nga baza.

Irani shënon 40-vjetorin e Revolucionit Islamik

Teheran, 2 shkurt - Irani po shënon 40-vjetorin e Revolucionit Islamik, i cili ka rrëzuar shahun, duke i dhënë fund sundimit monarkik - 2500 vjet të vjetër. Më 1 shkurt të vitit 1979, Ajatollah Ruhollah Khomeini është kthyer në Iran, pas 14 vjetësh në mërgim në Francë, për t'u bërë udhëheqës i Republikës Islamike të Iranit.

Të premten në gjithë Iranin janë dëgjuar sirenat në orën 9:33, që është koha kur aeroplani i Khomeinit ka aterruar në Aeroportin Ndërkombëtar të Teheranit, 40 vjet më parë.

Përvjetori, i njohur si Dhjetë Ditët e Agimit, përfundon më 11 shkurt, ditën kur ka rënë Qeveria e Mohammad Reza Pahlavit, duke i sjellë në pushtet klerikët shiitë.

Mijëra njerëz u mblodhën të premten në mauzoleun e Khomeinit në Teheran, ndërsa një grup i ushtrisë ekzekutoi himnet revolucionare.

BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.

E rrallë

Leopardi i arratisur terrorizon qytetin

Një leopard ka sulmuar gjashtë persona pasi ka terrorizuar për gjashtë orë qytetin indian Jalandhar. Macja e madhe tërhoqi zvarrë disa njerëz që po përpiqeshin ta kapnin. Pamjet e publikuara tregojnë turma të mëdha njerëzish që përpiqen ta kapin kafshën. Asnjë nga personat e sulmuar nuk mori lëndime serioze.

FOTO E DITES

Njerëzit kalojnë afër një peme të mbuluar me akull në Ontario të Kanadasë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Parku më i madh nënujor në botë

Bahrain po përgatitet për hapjen e parkut nënujor më të madh në botë këtë verë. Parku është kompletuar me aeroplanin "Boeing 747" të zhytur plotësisht në thellësinë 70 metra. Atraksioni turistik përfshin një sipërfaqe prej 100 000 metrash katrorë dhe brenda do ketë kopje të shtëpive tradicionale të tregtarëve të perlave, shkëmbinj nënujorë artificialë të

koraleve dhe skulptura të bëra nga materiali ekologjik.

BARSOLETA E DITËS

Burrë e grua flasin për pushimet por, para se të vendosin, e shohin nëse kanë buxhet. Pasi e analizojnë buxhetin, burri thotë:
- Valla unë nuk kam nevojë për pushime, se nuk jam aspak i lodhur.
Gruaja:
- Valla as unë, se po ndihem shumë në formë.

KINO ABC PRISHTINE

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Konkurrenca do t'ju bëjë më ambicioz sot. Do të arrini të përfundoni projekte që kishin kohë të lëna pas dore.

DEMI
Fokusi sot është puna për ju dhe duhet të justifikoni në familje një vonesë tej normave në punë që ju ka bërë t'i anashkaloni detyrimet tuaja.

BINJAKËT
Edhe pse sot duket se po mendoni për ndjenjat dhe emocionet e brendshme, arsyeja do t'ju bëjë që të hiqni dorë shpejt nga ëndërrimet tuaja.

GAFORRJA
Po merreni me hollësi të parëndësishme kur ,në fakt, gjërat kryesore për ju, i keni lënë pas dore.

LUANI
Po ndodhin shumë gjëra që nuk po arrini t'i menaxhoni. Bëni mirë ta kërkoni ndihmën e një personi tjetër megjithëse nuk ju pëlqen.

VIRGJËRESHA
Jeni në udhëkryq sa iu përket ndjenjave. Nuk po vendosni dot ndërmjet një personi të kaluar që është rishfaqur dhe një dashurie të re.

PESHORJA
Humorin tuaj të keq sot, mund ta durojnë vetëm miqtë e ngushtë dhe personat e afërt. Do të keni probleme në ambientin e punës.

AKREPI
Ndërmjet asaj që dëshironi dhe asaj që keni realisht ka një diferencë shumë të madhe, por që ju nuk po e vini re.

SHIGJETARI
Jeni të rrethuar me njerëz që mendojnë po njësoj si ju për tema të ndryshme. Kjo gjë do t'ju bëjë ditën më të këndshme.

BRICJAPI
Asnjë nuk mund t'ia lejojë vetes t'ju urdhërojë sot. Do t'i tregoni që jeni ju padronet e vetes suaj dhe asaj që doni të realizoni.

UJORI
Vetëm ose në çift ju nuk do të ndiheni në asnjë çast të lënë pas dore. Jeni aq vitale sa përçoni dhe thithni veç energji pozitive.

PESHQIT
Sot jeni shumë diplomat në sjellje dhe askush nuk do t'i kuptojë qëllimet reale që keni karshi situatave të caktuara.

Beyonce dhe Jay Z ofrojnë bileta të përjetshme për fansat që bëhen veganë

Beyonce vërtet dëshiron që edhe njerëzit e tjerë të bëhen veganë. Jo shumë kohë pasi i sfidoi fansat që të ndjekin një dietë 22 ditore të bazuar në perime, këngëtarja e "Drunk in Love" ka një sfidë tjetër. 37-vjeçarja ka bërë me dije në llogarinë e vet në "Instagram" se ata që do të ndjekin një stil jetësor prej vegani do ta kenë mundësinë të fitojnë bileta jetësore për koncerte.

Jennifer Lopezi përfundon dietën

Këngëtarja e njohur me prejardhje latine, Jennifer Lopez, ka përfunduar dietën. Kjo dietë që ishte pjesë e një sfide zgjati dhjetë ditë ku Jenniferi nuk duhet të hante sheqer dhe karbohidrate. Kështu, pas kësaj, Lopezi ka shpërndarë disa fotografi në rrjetet sociale ku shihet se është duke ngrënë pica me të dashurin.

Vishuni me stil si Rihanna

Këngëtarja nga Barbadosi, Rihanna, njihet si person e cila është e dhënë pas modës. Paraqitjet e saj çdoherë komentohen nga fansat e saj dhe nga disenjatorët. Dëshira e madhe për veshje Rihannën e shtyri ta hapë biznesin e rrobave të brendshme. Kështu Bazar ka përzgjedhur disa prej veshjeve më të bukura të Rihannës të cilat preferohet t'i vishni së paku një herë.

Shia LaBeouf lë aktrimin anash, dëshiron të jetë mësues

Shia LaBeouf dëshiron që ta lërë për pak kohë aktrimin dhe ta jetojë pasionin tjetër të tij, të japë mësim. "Page Six" ka raportuar se ylli i "Transformes" ka vendosur që aktrimin ta trajtojë si profesion të dytë dhe të jetë mësues me orar të plotë. "Duke marrë parasysh gjithë çfarë ka kaluar, është një mundësi shumë e mirë për ta ndryshuar ritmin e tij, një sens i normalitetit", ka thënë një burim pranë LaBeouf.

PROGNOZA SPORTIVE					
LEVERKUSEN - BAYERN M.	2	MONACO - TOULOUSE	1	REIMS - MARSEILLE	2

Shala: Do ta prezantojmë denjësisht hendbollin e Kosovës në Spanjë

Skuadra e Istogut do t'i zhvillojë dy ndeshjet e radhës ndaj Rincon Fertilidad Malaga në kuadër të një të tetës së finales të Kupës Sfiduese (Challenge Cup). "Do të mundohemi të prezantojmë sa më mirë qytetin tonë dhe gjithë hendbollin e Kosovës. Jemi të vetëdijshëm se do të jetë shumë vështirë pasi skuadra spanjolle është shumë cilësore dhe së fundi ka angazhuar disa lojtare shtesë. Kështu që premtojmë angazhim maksimal, ndërsa ndeshjet do të jenë përvojë e mirëseardhur për lojtaret tona, sidomos ato të reja", ka thënë Faruk Shala, trajner i KHF Istogu

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 1 shkurt - Trajneri i KHF Istogu, Faruk Shala, ka premtuar angazhim maksimal të skuadrës që ai e drejton për ta prezantuar sa më mirë hendbollin e Kosovës në Spanjë. Istogu, që bëri histori në garat evropiane, sot (e shtunë) dhe nesër (e diele) do të përballet në kuadër të një të tetës së finales të Kupës Sfiduese (Challenge Cup), me skuadrën spanjolle Rincon Fertilidad Malaga. "Do të përpiqemi ta prezantojmë sa më mirë qytetin tonë dhe gjithë hendbollin e Kosovës. Jemi të vetëdijshëm se do të jetë shumë vështirë pasi skuadra spanjolle është shumë cilësore dhe së fundi ka angazhuar disa lojtare shtesë. Kështu që premtojmë angazhim maksimal, ndërsa ndeshjet do të jenë përvojë e mirëseardhur për lojtaret tona, sidomos ato të reja", ka thënë Shala, i cili e ka pranuar se mungesa e disa hendbollisteve nuk e lejon Istogun të shpresojë shumë në dy përballjet ndaj skuadrës spanjolle. "Suksesi ndaj italianeve e kishte edhe çmimin e vet. Na janë lënduar lojtare të rëndësishme si Keta Venetski, Burneta Rama e Fatlinda Fejza. Pra, në Spanjë do të paraqitemi me fond të limituar lojtaresh. Për arsye personale nuk është më me ne as Arlinda Krasniqi. Kemi shpresuar të angazhojmë disa lojtare të huaja, por nuk ka qenë e mundur për shumë arsye", ka deklaruar Shala. Ndërsa Klubi i Istogut nëpërmjet një njoftimi ka falënderuar Komunën e Istogut, qytetarët, bashkatdhetarët, bizneset dhe gjithë ata që kontribuuan për skuadrën që shkroi një histori të re në garat evropiane.

Ndeshja e parë zhvillohet të shtunën nga ora 18:30, kurse ndeshja e dytë të dielën nga ora 11:00. Duhet cekur se skuadra e Istogut nëpërmjet një njoftimi për medie të premten në mesditë ka bërë me dije se ka pasur problem me fluturime nga Stambolli në Malaga për shkak të kushteve jo të mira atmosferike. KHF Istogu ka njoftuar se e ka informuar për vonesat skuadrën kundërshtare dhe Federatën e Hendbollit të Kosovës.

SHKURT

Sonte derbi Bashkimi - Ponte Prizreni

Në kuadër të xhiros së XVII në Superligën e Kosovës në basketboll në këtë fundjavë do të zhvillohen dy ndeshje mjaft interesante ku të shtunën, me fillim nga ora 19:00, Bashkimi është nikoqir i Ponte Prizrenit në derbin lokal që do të luhet në palestrën "Sezai Surroi". Të dielën, me fillim nga ora 17:00, Golden Eagle Ylli në Suharekë e pret Rahovecin, një tjetër kryendeshje e kësaj xhiroje. Ndërkaq dueli në mes të Lipjanit dhe Trepçës do të zhvillohet të shtunën me fillim nga ora 17:00, si dhe AFK Borea të dielën në orën 19:00 e pret në Pejë skuadrën e Z Mobile Prishtinës.

Kuka: Takim frytdhënës me ministrin Tahiri

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur kampionen olimpike, Majlinda Kelmendi dhe trajnerin Driton Kuka. Trajneri Kuka e ka quajtur takimin me ministrin Tahiri frytdhënës dhe pret që në të ardhmen ministritë t'i përkrahin sportistët elitarë. "Takim shumë frytdhënës me ministrin e Drejtësisë, Abelard Tahiri. Idetë tona të komunitetit sportiv për bashkëpunim u përkrahën fuqishëm nga ministri dhe besoj se sportistë elitarë së shpejti do të gjejnë përkrahje në forma të ndryshme nga ministritë e ndryshme. Model i kemi vendet e fuqishme perëndimore", ka shkruar Kuka në "Facebook".

Besa bllokoi transferimin e Balajt te Llapi

Talenti Liridon Balaj u prezantua ditë më parë si lojtar i skuadrës së Llapit, por nuk do të ketë mundësi të luajë për këtë klub në sezonin pranveror. Në fakt, Besa e Pejës e ka bllokuar transferimin e 19-vjeçarit në skuadrën nga Podujeva. Klubi pejan është ankuar në Federatën e Futbollit të Kosovës lidhur me këtë transferim dhe FFK-ja i ka dhënë të drejtë Klubit të Besës.

Kosova realizoi fitore bindëse kundër Norvegjisë

Përfaqësuesja e Kosovës në futsall ka shënuar fitore në ndeshjen e dytë të Grupit B në kuadër të parakualifikimeve për Kampionatin Botëror që po zhvillohen në Minsk. Pas humbjes nga Bjellorusia (0-5), "Dardanët" kanë shënuar fitore në duel me Norvegjinë, me rezultat bindës 5-1. Golat për Kosovën i shënuan Jeton Rukovci (4'), Ramadan Alaj (23', 35') dhe Dardan Topilla (38'), derisa golin e vetëm për norvegjezët e shënoi Wiseth (34'). Kësisoj, Kosova ka bërë një hap tejet të rëndësishëm për kualifikim në fazën e ardhshme. Ndeshjen e radhës djelmoshat e përzgjedhësit Ramadan Cimili do ta zhvillojnë kundër Andorrës, më 2 shkurt.

Salihu: Besa rikthehet në Superligë

Prishtinë, 1 shkurt - KF Besa e Pejës ka arritur marrëveshje për transferimin e sulmuesit Shkëmbim Salihu, i cili në pjesën pranverore do të djersijë fanellën e skuadrës pejane. "Kam arritur marrëveshje me Besën për gjashtë muaj. Shpresoj ta ndihmoj këtë klub për t'i arritur synimet për t'u inkuadruar në Superligë. Kemi një skuadër të mirë dhe jam optimist se do t'ia arrijmë këtij qëllimi", ka thënë Salihu për "Epokën e re". Sulmuesi në fjalë edhe në të kaluarën ka qenë pjesë e Besës, kurse në edicionin vjeshtor me sukses luajti për skuadrën e Vitisë, po ashtu në Ligën e Parë. Forma e sulmuesit në vjeshtë ka qenë e mirë, pasi ka shënuar gjashtë gola dhe ka asistuar në shtatë të tjerë.

Roma mund t'ia marrë trajnerin Shqipërisë

Romë, 1 shkurt - Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Christian Panucci, besohet se mund të emërohet në pozitën e trajnerit të Romës, nëse drejtuesit e klubit italian marrin vendim për ta shkarkuar Eusebio Di Francescon. E përditshmja italiane, "Il Messagero", raporton se Panucci mund të kthehet në Romë, ku kishte luajtur gjatë karrierës së tij si futbollist, pasi që e ardhmja e Di Francescos me verdhekuqtë nuk është e sigurt. Di Francesco rrezikon ta humbasë punën e tij nëse nuk arrin ta fitojë ndeshjes e së dielës, kundër Milanit, pas disfatës turpëruese me rezultat 7-1 kundër Fiorentinës. Panucci mund të emërohet në këtë pozitë pasi ai është një figurë e njohur për tifozët e Romës, për të cilët kishte luajtur në më shumë se 300 ndeshje gjatëve viteve 2001-2009, kur e kishte fituar dy herë titullin e Kupës së Italisë. Problemi në këtë pikë për Panuccin është kontrata që ai ka me Federatën Shqiptare të Futbollit, e cila skadon në nëntor të vitit 2019, kur mbyllet edhe faza kualifikuese e Evropianit të 2020-s.

Transferime me bollëk në Superligë

"Epoka e re"

Prishtinë, 1 shkurt - Ka përfunduar afati kalimtar i janarit edhe në futbollin e Kosovës. Skuadrat e IPKO Superligës në futboll kanë bërë mjaft transferime për sezonin pranveror. Kampionia vjeshtore, Prishtina, ka realizuar vetëm dy transferime, kurse nënkampioni, Feronikeli, pesë transferime. Befasia më e madhe ishte rikthimi i Hamed Kones, i cili edhe në të kaluarën ishte pjesë e skuadrës nga Drenasi. Duarkryq nuk ka qëndruar as Llapi që ka realizuar mjaft transferime e ku vlen të veçohet angazhimi i Lorik Aliut që për disa vjet ishte jashtë futbollit si pasojë e lëndimeve. Gjilani nuk është në garë për mbijetesë, por reagimi i drejtuesve të klubit ka qenë mjaft i madh në afatin kalimtar, duke angazhuar tetë futbollistë. Edhe Drenica ka bërë disa transferime, kurse kampionët e Dritës kanë angazhuar shtatë futbollistë pas rezultateve jo të mira në vjeshtë. Flamurtari i Prishtinës në kuadër të përforcimeve ka arritur t'i transferojë sulmuesit e njohur Florim Bërbatovci dhe Shend Kelmendi. Aktive janë treguar edhe Trepça '89, Ballkani, Liria, Ferizaj dhe KEK-u.

Lista e skuadrave me përforcime

Prishtina: Adi Hyla, Andi Maraj.

Feronikeli: Riza Zhdrella, Met Millaku, Adenis Shala, Hamed Kone, Esat Jashari.

Llapi: Blendi Miftari, Flamur Bajrami, Elvis Prenqi, Miran Maksuti, Lorik Aliu, Rron Statovci, Remzi Selmani, Hajdin Salihu, Donik Osmani.

Gjilani: Vilson Lila, Kledi Koci, Shpend Asani, Kushtrim Shabani, Fiton Hajdari, Semir Hadzibuliq, Keita Lanzeni Aziz, Keita Alassane Razak.

Drenica: Besnik Shehu, Atdhe Grajqevci, Diar Prokshi, Argjend Bardhi, Nicolas Andrews, Prince Balde.

Drita: Kyrian Chinazorm Nwabueze, Klajdi Burba, Mario Kirev, Përparim Osmani, Sedat Berisha, Festim Krasniqi, Denis Haliti.

Flamurtari: Florim Bërbatovci, Ardit Nika, Melos Zenunaj, Shend Kelmendi, Vigan Rexhaj, Leon Gashi, Angel Granchov, Adamou Moussa Issa.

Trepça '89: Engjell Hoti, Franck Herman Betra, Traore Lassine, Taulant Avdyli, Albert Kaqiku.

Ballkani: Bledar Hajdini, Dardan Jashari, Visar Sahiti, Ledion Muçaj, Tarik Cmajcani, Almir Ajzeraj, Demir Avdiq, Blin Baraliu, Edvin Kuq.

Liria: Norales Nunez Roby Alberto, Martins Aristegui, Jinenez Vivas Luis Manuel,
Ramirez Valdivia Guillermo Abel, Riascos Jhonny, Nieves Vargas Armando Jose.

Ferizaj: Viktor Kuka, Ermal Krasniqi, Egzon Shabani, Hysen Demiri, Durim Gashi, Dardan Çerkini, Veton Shabani, Ajradin Cuculi, Armend Aliu, Demir Huseni, Burhan Mustafi.

KEK-u: Enis Zaberxha, Pleurat Hajdini, Isa Eminhaziri, Egzon Qerimi, Drin Hodaj, Amir Prishtina, Shkelzen Jashanica, Besart Dushi, Ardian Musliu, Valmir Kutllovci.

Kampionët e Golden States ndalen nga Philadelphia

Oakland, 1 shkurt - Surprizë në ndeshjet e radhës të NBA-s. Kampioni në fuqi i kampionatit amerikan të basketbollit, Golden State Warriors, ka pësuar një humbje të papritur përballë Philadelphia 76ers. Këtu është ndalur seria prej 11 fitoresh radhazi e GSW-s, teksa në "Oracle Arena" është regjistruar rezultati 113-104. Joel Embiid dhe Ben Simmons për ekipin fitues shënuan nga 26 pikë secili, ndërkohë që i pari pati edhe 20 kërcime. Fitore e rëndësishme mund të konsiderohet edhe ajo e Milwaukee Bucksit në fushën e Toronto Raptorsit, me 13 pikë diferencë, 105-92. Giannis Antetokounmpo bëri paraqitjen më të mirë, duke realizuar 19 pikë dhe 9 kërcime.



REZULTATET

Detroit Pistons - Dallas Mavericks	93-89
Orlando Magic - Indiana Pacers	107-100
Toronto Raptors - Milwaukee Bucks	92-105
San Antonio Spurs - Brooklyn Nets	117-114
Golden State Warriors - Philademphia	104-113

SHKURT

"El Clasico" edhe në Kupë

Është hedhur shorti për ndeshjet gjysmëfinale në Kupën e Mbretit në Spanjë, kurse edhe këtu do të ketë "El Clasico" në mes të Barcelonës me Real Madridin. Ndeshja e parë në mes të Barçës dhe Realit zhvillohet në "Camp Nou" më 6 shkurt, kurse ajo kthyese luhet më 27 shkurt në "Santiago Bernabeu". Përballja tjetër e gjysmëfinales është në mes të Real Betisit dhe Valencias.

Whyte ose Milleri, kundërshtar i Joshuas

Anthony Joshua me "shumë mundësi" do ta anulojë datën e 13 prillit për një duel në stadiumin "Wembley", ka bërë me dije promotori i tij, Eddie Hearn. Joshua, kampion i botës në versione të ndryshme në kategorinë e rëndë në boks, kishte nënshkruar marrëveshje për të boksuar dy herë në stadiumin kombëtar, ku i pari ishte fitorja e 22 shtatorit ndaj Alexander Povetkin. Por, Hearn ka bërë me dije se një duel i ri me Dillian Whyte në Britani ose me amerikanin Jarrell Miller në New York do të jenë sfidat e ardhshme të Joshuas. "Ndeshja më 13 prill është pak e pritshme të realizohet", ka thënë Hearn.

Benzema në histori të Realit

Fillimi i sezonit nuk ishte i lehtë për Karim Benzemanë, mirëpo ai është rikthyer të shënojë rregullisht. Francezi realizoi dy herë në Kupën e Mbretit. Tashmë sulmuesi regjistron 209 gola, duke parakaluar në këtë renditje Hugo Sanchezin. Pas 446 ndeshjeve të luajtura, 31-vjeçari është futur në historinë e madrilenëve si futbollisti i gjashtë që ka realizuar më shumë. Ai është në ndjekje të Pushkas, i cili ka shënuar 242 gola. Renditja kryesohet nga Cristano Ronaldo me 451 gola, i ndjekur nga Rauli me 323 dhe Di Stefano me 308 gola.

Conte: Ja pse e refuzova Realin

Pas shkarkimit të Julen Lopeteguit nga pozita e trajnerit të Real Madridit, raportohej se Antonio Conte do të bëhet trajneri i ri i madrilenëve. Megjithatë, italiani e ka bërë të qartë se në atë moment "Los Blancos" ishte si një "patate e nxehtë" dhe nuk do të ishte vendim i mençur ta merrte kontrollin në atë kohë. "Puna në Real Madrid ishte si një 'patate e nxehtë' në atë kohë. Mendova se është më mirë të mos shkoj. Kishte mundësi, por nuk më pëlqen të arrij në një klub në mes të sezonit. Preferoj të marr drejtim nga fillimi", ka thënë Conte në një intervistë për "La Gazzetta dello Sport".

Suarezi dëshiron të pensionohet në Barcelonë

Sulmuesi uruguaian i Barcelonës, Luis Suarez, ka bërë me dije se dëshiron të pensionohet nga futbolli në Barcelonë, duke e pranuar se për të do të ishte e mrekullueshme t'i kalonte edhe sezonet e fundit të karrierës në "Camp Nou". "A do të doja të pensionohem në Barcelonë? Po, natyrisht. Shumë pak njerëz e kanë mundësinë ta bëjnë këtë gjë, por mendoj se kjo është dëshira e të gjithë lojtarëve. Ta përfundosh karrierën në klubin më të mirë të botës do të ishte gjëja më e mrekullueshme. Por, kjo gjë do të jetë e vështirë pasi shumë pak njerëz e kanë arritur këtë synim", ka thënë Suarezi.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transportation

SHPALLJA E REKRUTIMIT
Oglas za regrutiranje

Institucioni: **Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit**
Institucija: **Ministarstvo Infrastrukture i Transporta**

Institucioni/institucija MIT/MIT kërkon të punësojë (titullin e pozitës)
në (departamentin/drejtoratin/divizionin,njësinë)e /želi da regrutuje (naziv posla u odeljenju/direkciji,diviziji ili sektoru**)** **Divizioni për Prokurim/ Divizija za nabavku;**

Titulli i vendit të punës /Naziv radnog mesta: **Zyrtar/e i/e Prokurimit / Službenik/ca za javne nabavke**

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës? Niveli profesional 2 grada 9 (BKK 7), Funkcionalna kategorija i stepen radnog mesta/ Nivo upravlanja 2-stepen 9 (BKK 7),

Numri i referencës së vendit të punës/Broj radnog mesta/ RN00004309

(Shënoni saktësisht por me pak fjale detyrat dhe përgjegjësitë kryesore)/(Naznačite tačno i kratkim rečima glavne odgovornosti**):**

- Analizon aktivitetet aktuale të prokurimit dhe rekomandon përmirësimin përmes metodave më efikase të prokurimit dhe standardizimit të procedurave të prokurimit si dhe merr pjesë në hartimin dhe zhvillimin e dokumenteve të prokurimit
- Pranon të gjitha shkresat, për prokurim dhe regjistrimin e tyre në programet kompjuterike, faturave dhe dokumentacionit tjetër, që është i adresuar në Departamentin e Prokurimit
- Mban evidenca të kërkesave për prokurim, si dhe bën dosjen dhe arkivimin e tyre
- Pranon lëndë të përfunduara nga zyrtarët e prokurimit, regjistron ato në programe kompjuterike dhe i arkivon
- Shpërndan ftesa për oferta për blerje konkurruese
- Merr pjesë në komisionet për vlerësimin e ofertave dhe siguron mbajtjen e të dhënave për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës, për veprimet dhe vendimet e marra gjatë çdo fazë të procesit, si dhe siguron që komentet e të gjithë anëtarëve të shënohen dhe se çdo anëtar t'i nënshkruan këto komente
- Pranon oferta nga kompanitë në kohën e paparë në tender-dokument
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikqyersi
- Analizira trenutne aktivnosti nabavke i preporučuje poboljšanje putem efikasnijih metoda nabavke i standardizacije procedura nabavke i učestvuje u izradi i izradi dokumenata nabavke
- Prima sve dokumente za nabavku i vrši njihovu registraciju u kompjuterskim programima, faktura i druge dokumentacije upućenu Departmanuza nabavku
- Drži evidenciju zahteva za nabavku, kao i stvara dosijee i arhivira iste;
- Prima završene predmete od službenika za nabavku, evidentira ih u kompjuterskim programima i arhivira iste,
- Šalje pozive za ponude za konkurentnu kupovinu,
- Učestvuju u komisijama za procenjivanje ponuda i obezbeđuje držanjepodataka za sve učesnike u tenderu, o radnjama i odlukama koje se donose u svakoj fazi procesa, i obezbeđuje da komentari svih članova su evidentirani i da svaki član potpisuje ove komentare:
- Prima ponude od kompanija u vremenu predviđenom u tenderskoj dokumentaciji;
- Obavlja i druge zadatke u skladu sa svrhom radnog mesta koji se mogu povremeno zahtevati od nadzornika;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim - Uslovi za učešće na regrutaciji

(Shënoni kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit sipas ligjit për shërbimin civil/Navedite uslove za učešće u procesu regrutacije po Zakonu Javne Službe/

Procedurat e konkurrimit-Procedure konkurisanja
Shënoni nëse procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatë të jashtëm si dhe nëpunës civilë ekzistues ose nëse është procedurë e brendshme vetëm për nëpunës civilë ekzistues - Navedite da li je procedura konkurisanja javna za spoljne kandidate, ili da li je procedura interna samo za postojeće civilne službenike

Procedura e konkurrimit është e hapur për gjithë kandidatet te jashtëm si dhe për nëpunës civil/ Procedura konkurisanja je objevljena i za javne sluzbenike koji rade u intitucije .

Shkollimi i kërkuar/Minimum obrazovanja koje se zahteva:
(Shënoni shkollimin që kërkohet realisht për këtë vend pune/(Navedite stepen obrazovanja koje se realno traži za ovo radno mesto)/

- **Diplomë Universitare: Ekonomik, Juridik / Univerzitetska Diploma: Ekonomski, Pravni**

Aftësitë,përvoja dhe atributet tjera që kërkohen/Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju.

(Përshkruaj aftësitë, përvojën dhe vetitë personale të cilat janë të kërkuara dhe të cilat munden më qenë të dëshiruara. Këto duhet të kenë lidhje me punën dhe të jenë objektive./(Opišite sposobnosti, iskustvo i lične osobine koje se zahtevaju kao i one koje su poželjne. One moraju da budu povezane sa radon i da budu objektivne.

- Diplomë Universitare: Ekonomik, Juridik
- Dy (2) vitë përvojë pune profesionale
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e prokurimit publik;
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
- Aftësia për të organizuar punën e vet dhe për te koordinuar stafin e nivelit administrativ
- Shkathtësi hulumtuese , analitike dhe të vlerësim të informacionit
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, PowerPoint, Access)
- Univerzitetska Diploma: Ekonomski, Pravni
- dve (2) godine profesionanlog radnog iskustva.
- Duboko i specifično znanje u oblasti javnih nabavki
- Sposobnost u rešavanju problema o tehničkim ili proceduralnim pitanjima koja proizilaze od radnog procesa
- Sposobnost za organizovanje svog posla i za koordinaciju osoblja administrativnog nivoa
- Sposobnostza istraživanje, analizu i procenjivanje informacije
- Kompjuterske veštine na softverske programe (Word, Excel, PowerPoint, Access)

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin/ Zakonski i podzakonski akti koji regulišu zaposljavanje
(Shënoni një përshkrim të shkurtë të përzgjedhjes dhe të rregulloreve ekzistuese që rregullojnë rekrutimin - Navedite kratak opis izbora i postojećih pravilnika koji regulišu zapošljavanje

Nëpunësit e shërbimit Civil të Republikës së Kosovës i nënshtrohen **Sipas Ligjit për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149/Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Sluzbi, - Rregullorja nr 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë/ Uredba br. 21/2012 O Napredovanju u Karijeri Civilnih Službenika**
Rregullores nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës dhe standardeve të sjelljes dhe etikes të përshkruara në kodin e mirësjelljes së shërbimit civil/Uredbe br. 02-2010 o procedurama regrutacije u Civilnu Službu Kosova i standardima ponašanja i etikeopisanih u kodeksu ponašanja civilne službe

Kohëzgjatja e emërimit/ Vremenski rok imenovanja: **DY (2) VITE**
Kohezgjatja e kontratës ME AFAT - JO KARRIERËS
(Naznačite ako je imenovanje na odredjeno ili na neodredeno vreme i vremenski rok)/
Neograničeno, u Karijeri
Data e mbylljes së konkursit/Datum zatvaranja konkursa:
(Shënoni kohëzgjatjen e konkursit dhe datën e mbylljes/ Naznačite vremenski rok trajanja konkursa i krajni rok)
Nga 02.02.2019 deri 16.02.2019 në ora 16:00/ od 02.02.2019 do 16.02.2019 u 16:00 časova

Paraqitja e kërkesave/Prijeva zahteva
(Shënoni vendin ku dhe kur mund të merren formularët e aplikacionit si dhe vendin ku duhet të dorëzohen dhe adresa e plotë e institucionit pranues) / (Navadite kako i gde se mogu dobiti obrasci za konkurisanje, mesto gde ih treba predati kao i tačna adresa institucije koja će ih primiti)
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, Rr. Nëna Terezë , Ndërtesa e ish-Gërmisë, kati II – zyra A 204/ Ministrastvo Infrastrukture i Transporta,Trg Majka Tereza, Bivša zgrada Germije, II sprat, kancelarija br. A 204

Kërkesat specifike/ Specifični zahtevi
(Shënoni nëse ka ndonjë kërkesë specifike shëndetësore ose fizike për kryerjen e detyrave të punës, përfshirë kërkesën për vlerësim mjekorë)/(Nevedite ako ima neki specifičan zahtev zdravstvene ili fizičke prirode za izvršavanje radnih obraveza, uključujući zahtev za lekarsko mišljenje).

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë/Kosovska javnana sluzba pruža jednake uslove zapošljavanja za sve državljane Kosova i prima aplikacije svih lica muškog i ženskog roda iz shih zajednica na Kosovu.

"Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtaret e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 te Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës",-Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prava da budu predstavljeni prporcionalno na organima Javne službe na lokalnom i centralom nivou, kao što je naznačeno i Čl.11, paragraf 3 Zakona Br.03/L-149 o Javnoj Službi Republike Kosovo.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen/Zahtevi postati nakon zatvaranja konkursa neće se uzeti u obzir. Nekompletirani zahtevi mogu biti odbijeni.
Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen/Zbog velikog broja dobijenih zahteva, biće pozvani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.
Shënoni emri dhe mbiemri, numri i telefonit të personit i cili mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje/ Napišite ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slučaju bilo kakvih nedoumica;
Divizioni i Personelit- Nr (038) 200 28 547 ose (038) 200 28 498

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transportation

SHPALLJA E REKRUTIMIT
Oglas za regrutiranje

Institucioni: **Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit**
Institucija: **Ministarstvo Infrastrukture i Transporta**

Institucioni/institucija MIT/MIT kërkon të punësojë (titullin e pozitës)
në (departamentin/drejtoratin/divizionin,njësinë)e /želi da regrutuje (naziv posla u odeljenju/direkciji,diviziji ili sektoru**)** **Divizioni për Prokurim/ Divizija za nabavku;**

Titulli i vendit të punës /Naziv radnog mesta: **Zyrtar/e i/e Lartë i/e Prokurimit / Visoki službenik/ca za nabavke**

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës? Niveli profesional 3 grada 8 (BKK 8), Funkcionalna kategorija i stepen radnog mesta/ Nivo upravlanja 3-stepen 8 (BKK 8),

Numri i referencës së vendit të punës/Broj radnog mesta/ RN00004308

(Shënoni saktësisht por me pak fjale detyrat dhe përgjegjësitë kryesore)/(Naznačite tačno i kratkim rečima glavne odgovornosti**):**

- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të njësisë
- Udhëhëq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet dhe kryen detyra të specializuara në fushën specifike si dhe ndihmon stafin tjetër të institucionit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre
- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të njësisë dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet
- Siguron që të gjitha kërkesat për prokurim janë në pajtim me legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik
- Përgatit kontrata dhe siguron që metodat e prokurimit dhe teknikat janë të kuptueshme dhe zbatohen nga ana zyrtaret tjerë të prokurimit
- Përgatit forma dhe procedura standarde, varësisht nga metoda e prokurimit dhe siguron që ftesat për oferta për tenderë dhe dërgimi i tyre është bërë me kohë
